



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Kryetari



**PLANI I PUNËS
TË KRYETARIT TË KOMUNËS – QEVERISË KOMUNALE PËR VITIN 2019**

Janar, 2019

Hyrje

Ky Plan i punës paraqet prioritetet e Kryetarit të komunës, të qeverisë komunale për vitin 2019 dhe jep përmbledhje të objektivave, aktiviteteve të planifikuara, si dhe realizimin e tyre. Po ashtu, përcakton edhe treguesit, si dhe afatet kohore për kryerjen e secilit prej aktiviteteve dhe objektivave të parapara, por që ky plan gjatë vitit 2019 do të mund të evoluojë.

Hartimi i këtij plani është një reflektim i angazhimit të vazhdueshëm për t'i kanalizuar nismat për planifikim të objektivave, përkatësisht prioritetëve, të cilat do të mund të realizohen bazuar në planifikimin buxhetor të vitit 2019, për të përmirësuar cilësinë e jetës për të gjithë qytetarët tanë. Natyrisht se ka sfida gjatë përmbushjes së këtyre objektivave, por me një angazhim të përbashkët mund të arrihen rezultate të kënaqshme.

Prioritetet kryesore gjatë vitit 2019:

- Menaxhimi efektiv dhe transparent i buxhetit të komunës;
- Shfrytëzimi racional i mjeteve buxhetore;
- Transparencë dhe llogaridhënie për qytetarët e administratës komunale;
- Angazhimet e vazhdueshme për realimin e të hyrave të planifikuara buxhetore si dhe të gjitha formave dhe mundësive të burimeve tjera të të hyrave;
- Fillimi i implementimit të projektit për kyqjet individuale në rrjetin e ujësjellësit;
- Studimi i fizibilitetit për Stacionin e Autobusve;
- Studimi i fizibilitetit për Tregun për prodhues vendor;
- Rivitalizimi i stadiumit “Musa Abazi”
- Përmirësimi i infrastrukturës së terrreneve sportive;
- Qendra Inovative e Vushtrrisë
- Funksionalizimi i Muzeut të Qytetit
- Renovimi i Stadiumit “Ferki Aliu” (Faza I)
- Ndërtimi i parqeve në hapësira publike
- Ndërtimi dhe rritja e vend parkingjeve publike
- Zgjerimi i rrjetit të ndriçimit publike
- Vazhdimi i punimeve në shtratit e lumit “Podrança”
- Ndërtimi i urave dhe mureve mbrojtëse,
- Rregullimi i lumit “ Terrstena “

- Rregullimi i lumit “ Terrstena “
- Zgjerimi i rrjeteve te vendosjes së kamerave në qytet dhe shkolla
- Ndërtimi i urës në Dobërllukë
- Ndërtimi i sheshit “Ahmet Krasniqi”
- Rregullimi i varrezave te martireve
- Hartimi i hartave zonale
- Asfaltimi i rrugës Vushtrri- Nadakoc - Pestovë
- Ndërtimi i QMF-së në Vushtrri
- Ndërtimi i Shkollës së muzikës
- Ndërtimi i çerdhes së re (projekte tre vjeçare)
- Sigurimi i shujtave ditore në arsimin fillore
- Raportimi i rregullt në kuvendin e komunes (çdo 3 muaj) për të hyrat dhe shpenzimet buxhetore e sipas nevojës edhe sipas kërkesës së kuvendit;
- Implementimi sipas planifikimit dhe me kohë i projekteve kapitale si dhe angazhimi per shpenzim 100 % të mjeteve financiare të investimeve kapitale sidomos mjeteve të grantit qeveritar;
- Ngritja e bashkepunimit me organet e nivelit qendror në implementimin e projekteve të cilat jane parapare të financohen nga buxheti i Republikës së Kosoves;
- Shfrytëzimi sa më racional i pronave (tokave dhe objekteve) në pronësi të komunës përmes dhënies në shfrytëzim me qëllim të krijimit të të hyrave buxhetore;
- Ndërmarrja e masave per lirimin e pronave komunaletë uzurpuara; publikimi i të gjithë shfrytëzuesve të pronës komunale;
- Angazhimet për gjetjen e donatorëve per investime në komunë;
- Investimi dhe funksionalizimi i Parkut Industrial në fsh.Lumadh;
- Rritja e prodhimtarisë bujqësore përmirësimi i cilësisë së atyre prodhimeve;
- Organizimi i trajnimeve dhe këshillimeve profesionale si dhe subvencionimit të bujqëve,
- Mbrojtja e pyejeve nga prerësit ilegal;
- Ndërtimi i rrjetit te kanalizimeve në zonat rurale;
- Angazhimet për gjetjen e donatoreve per investime ne ndertimin e kolektorit kryesor buze lumit „Silnica“ dhe impijantit per punimin e ujrave te zeza;
- Kujdesi për ambient të pastërt si dhe menaxhimi më i mirë i mbeturinave duke marrë për bazë planin për menaxhimin e mbeturinave;
- Funksionalizimi i QSHQ-së si dhe ofrimi i shërbimeve sa më cilësorë ndaj qytetarëve për sa i përket lëshuarjes së dokumenteve personale;
- Gjithperfshirja në arsim dhe ngritja e cilësisë së punës në institucionet e arsimit;

- Shtrirja e rrjetitë mësimit parashkollor në të gjitha shkollat fillore të komunës,
- Ngritja e kapaciteteve dhe cilësisë së shërbimeve shëndetësore,
- Promovimi perkatesisht avancimi i aktiviteteve kulturore, të rinisë dhe në lëmin e sportit,
- Përmes fondit të subvencioneve, ofrimi i mbështetjes së klubeve sportive, organizatave të dalura nga lufta e UCK-së, organizatave rinore, OJQ –ve tjera të komunës, si dhe kategorive tjera në veqanti familjeve skamnore.
- Bashkepunimi me organet e nivelit qendror veqanerisht me Qeverinë dhe ministritë e linjes në aspektin e zbatimit të ligjshmerisë me rastin e marrjes së vendimeve me rëndësi dhe interes për komunën dhe qytetaret,
- Bashkepunimi me organizatat vendore e ndërkombetare,
- Bashkepunimi me KFOR-in, dhe Policinë e Kosovës në aspektin e sigurisë së përgjithshme;
- Bashkepunimi me shoqëritë civile dhe qytetaret për pjesëmarrje në proceset e vendim marrjes në komunë;

Planifikimi sipas drejtorive:

Buxhet dhe financa

Me të filluar viti i ri fiskal, Drejtoria për BF në bashkëpunim me të gjitha drejtoritë tjera komunale, përgatit Planin e rrjedhjes së parasë për vitin fiskal 2019, Planin për bartjen e të hyrave të mbetura nga viti 2018, si dhe dokumentacionin e nevojshëm për personat e autorizuar për shpenzime dhe të hyra.

Më poshtë në formë tabelare po i paraqesim në mënyrë kronologjike punët që i kryen Drejtoria për BF gjatë gjithë vitit fiskal 2019

Nr.	Drejtoria	Objektivat	Aktivitetet	Afati	Ndërlidhja me
1	Drejtoria për Buxhet dhe Financa	1.Përgatitjet fillestare për fillimin e vitit fiskal 2019	1.Takime me stafin lidhur me detyrat dhe përgjegjësitë e secilit punëtor	Janar-dhjetor/2019-çdo javë	BF
2		2.Rregullimin e dokumentacionit për zyrtarët me autorizimet e veçanta: nëpunësi administrativ i pagesave, personi autorizues, personi aprovues, personi zotues dhe certifikuesi	2.Plotësimi i kërkesës për qasje të përdoruesve në SIMFK.	Janar/2019	Të gjitha programet buxhetore të drejtorive

3	3.Pasqyrat financiare për buxhetit për vitin 2018	3.Plotësimi dhe dorëzimi i PVF në MF	Janar/2019	Të gjitha programet buxhetore të drejtorive
4	4.Raporti vjetor për të hyrat dhe shpenzimet	4 Përpilimi i raportit vjetor për të hyrat dhe shpenzimet për vitin 2018; paraqitja në K.K	Janar/2019	Të gjitha programet buxhetore të drejtorive
5	5.Përgatitja e rrjedhës së parasë për të gjitha programet për vitin 2019	5.Plotësimi i formularëve të rrjedhës së parasë në bazë të planifikimit të buxhetit dhe dorëzimi në MF.	Janar/2019	Të gjitha programet buxhetore të drejtorive
6	6. Të hyra vetanake të pashpenzuara nga viti 2018	6. Bartja e të hyrave të pashpenzuara nga viti 2018; paraqitja në K.K	Shkurt /2019	Të gjitha programet buxhetore të drejtorive
7	7. Përgatitja e listave për të gjithë borxhlinjtë e tatimit në pronë.	7. Shpërndarja e faturave të tatimit në pronë.	Janar – shkurt 2019	Spektori i tatimit në pronë
8	8. Përgatitja e listave për të hyrat e paarkëtuara të taksës në firmë	8. Evidentimi i të gjitha bizneseve që ushtrojnë veprimtarinë e tyre lidhur me të hyrat e paarkëtuara për ngarkesën e taksës në firmë	Janar /2019	Spektori i taksës në firmë
9	9. Faturat e papaguara	9. Evidentimi i të gjitha faturave të papaguara nga viti 2018	Janar/2019	Të gjitha programet buxhetore të drejtorive
10	10. Inventari dhe pasuria	10. Përditësimi i të dhënave për inventar dhe pasuri	Janar-dhjetor/2019	Të gjitha programet buxhetore të drejtorive

11	11. Barazimi mujor i shpenzimeve dhe të hyrave në sistemin FB	11. Përmbajtja e afatit kohor në bazë të Udhëzimit administrativ 02/2010	Çdo muaj/2019	Të gjitha programet buxhetore të drejtorive
12	12. Raporti i shpenzimeve dhe të hyrave vetanake për tremujorin e parë 2019.	12. Raporti lidhur me realizimin e buxhetit dhe inkasimin e të hyrave për të gjitha programet buxhetore; paraqitja në K.K	Prill/2019	Të gjitha programet buxhetore të drejtorive
13	13. Prezantimi i Qarkores 01/2020 kufijve të parë buxhetor dhe përpunimi i buxhetit për vitin 2020 konform qarkoreve të marra nga MEF-i	13. Të harmonizojë kërkesat e drejtorive për planifikimin e buxhetit për vitin fiskal 2020; paraqitja në K.K	Maj-qershor/2019	Të gjitha programet buxhetore të drejtorive
14	14. Rrishikimi i buxhetor (varësisht nga kërkesat e MEF-it)	14. Përgatitja e formularëve lidhur ndryshimet buxhetore; paraqitja në K.K	Qershor-korrik/2019	Të gjitha programet buxhetore të drejtorive
15	15. Raporti i shpenzimeve dhe të hyrave vetanake për gjashtëmujorin e parë 2019	15. Raporti lidhur me realizimin e buxhetit dhe inkasimin e të hyrave për të gjitha programet; paraqitja në K.K	Korrik/2019	Të gjitha programet buxhetore të drejtorive
16	16. Përcjellja e realizimit të shpenzimeve buxhetore të mjeteve sipas dinamikës së paraparë për gjashtëmujorin e parë për vitin fiskal 2019	16. Raportimi lidhur me projektet e realizuara në bazë të planifikimit të buxhetit	Korrik/2019	Të gjitha programet buxhetore të drejtorive
17	17. Shqyrtimi i Rregullores së tatimit në pronë për vitin 2019	17. Dorëzimi në MEF; paraqitja në K.K	Korrik/2019	
18	18. Pasqyrat financiare për vitin 2018 dhe raporti i AP	18. Shqyrtimi i raportit të auditimit dhe hartimi i planit të veprimit për të gjeturat e AP; paraqitja në K.K	Korrik/2019	Të gjitha programet buxhetore të drejtorive

19	19. Përgatitja e tregueseve final buxhetor për vitin 2020 konform qarkores së 02/2020 nga MEF-i	19. Harmonizimi i të gjitha kërkesave të drejtorive dhe finalizimi i buxhetit për vitin fiskal 2020.	Shtator/2019	Të gjitha programet buxhetore të drejtorive
20	20. Draft buxheti për vitin 2020	20. Paraqitja e draft-buxhetit në K.K	Shtator/2019	Të gjitha programet buxhetore të drejtorive
21	21. Raporti i shpenzimeve dhe të hyrave vetanake për nëntëmujorin e parë 2019	21. Raporti lidhur me realizimin e buxhetit dhe inkasimin e të hyrave për të gjitha programet; paraqitja në K.K	Tetor 2019	Të gjitha programet buxhetore të drejtorive
22	22. Vlerësimi i punëtorëve	22.Vlerësimi i performancës së punëtorëve	Dhjetor/2019	BF
23	23. Përgatitjet për përmbylljen e vitit fiskal buxhetor 2019	23.Mbyllja e vitit fiskal sipas rregullores për mbylljen e vitit fiskal 2019	Dhjetor/2019	Të gjitha programet buxhetore të drejtorive

Ekonomi, bujqësi dhe pylltari

Nr .	Emri i projektit	Shuma-€	Komuna	Donatorët	Periudha kohore	Zhvillimet
1.	Zhvillimi i aktiviteteve dhe përpjekjet për kushte më të mira në QKB				Janar-dhjetor	Zvogëlimi dhe eliminimi i të gjitha barrierave për të bërë biznes. Ne presim që fermerët dhe bizneset të regjistrohen, të aplikojnë dhe t'i marrin, gjegjësisht të pajisen me certifikatë biznesi.
2.	Mbulimi i normave të interesit për bizneset e reja.	100,000.00			Janar-shkurt 2019	Me këtë projekt kemi synimin e përkrahjes së bizneseve-fermerëve me qëllim të rritjes së vendeve të reja të punës. Këto vende pune do të krijohen në formën e vetpunësimit.

	Projekti ka filluar në vitin 2018 dhe vazhdon në vitin 2019.					
3.	Përkrahja e bizneseve të reja dhe ekzistuese me afarizëm mbi një vit.	100,000.00	60,000,00 10	40,000,00 21	Janar-shkurt 2019	Me këtë projekt synohet përkrahja e bizneseve Start Up
4.	Ngritja e serrave 90234	30,000.00	25,000,00 10	5,000,00 21	Shkurt-mars 2019	Me këtë projekt ne synojmë zhvillimin e sektorit të bujqësisë, duke ngritur serra me participim të fermerëve.
5.	Makina për lëvrim, frezim etj.	75,000.00	50,000,00 10	25,000,00 21	Shkurt-mars 2019	Rritja dhe forcimi i ekonomive familjare në sektorin e bujqësisë
6.	Makina për spërkatje	25,000.00	15,000,00 10	10,000,00 21	Prill-maj 2019	Ky projekt mundëson fleksibilitet dhe kualitet në punën e fermerëve
7.	Blerja e makinave mjelëse 90233	20,000.00	15,000.00 10	5,000.21	Prill-maj 2019	Me këtë projekt kemi synimin e përkrahjes së bizneseve-fermerëve me qëllim të rritjes së vendeve të reja të punës. Këto vende pune do të krijohen në formën e vetpunësimit.
8.	Makina për mbjelljen e lakrave	20,000.00	15,000,00 10	5,000,00 21	Maj-qershor 2019	Rritja dhe forcimi i ekonomive familjare në sektor të bujqësisë
9.	Makina për shpërndarjen e plehut organik	30.000	20,000,00 10	10,000,00 21	Shtator – tetor 2019	Këtë projekt synojmë të realizojmë me bashkëfinancim me fermerët, duke pas parasysh që një numër i madh i fermerëve në Vushtrri merren me blegtori dhe bujqësi.
10.	Ngritja e pemishteve (arra, lajthi etj.)	25,000.00	20.000,00 10	5.000,00 21	Tetor-nëntor 2019	Me këtë projekt kemi synimin e përkrahjes së fermerëve, me qëllim të krijimit të vendeve të reja

						të punës. Këto vende pune do të krijohen në formën e vetpunësimit.
10.	Projektet në bashkëfinancim me donatorë (bujqësi)	150.000.00	50.000,00 10	100.000.0 0 21	Janar – dhjetor 2019	Është projekt mjaft i rëndësishëm dhe ndikon në zhvillimin ekonomik ku vend të rëndësishëm zë bujqësia, ku edhe krijohen vende pune si të vetpunësuar
11.	“Dita e patates”			MBPZHR	1-10/Tetor /2019	Organizimi “Dita e patates”që nga viti 2012 është në organizim të organeve komunale dhe ka karakter të promovimit të kësaj kulture nga komuna jonë, fermerëve të vyeshëm, sukseseve të kompanisë ”Pestova”, investimeve nga fermerët dhe kompania, si dhe paraqitjen e inovacioneve teknologjike për çdo vit.
12.	Mbjelljet pranverore/ vjeshtore				-Shkurt/prill -Shtator/nëntor /2019	Bazuar në aktivitetet e fermerëve vushtrrias dhe resurseve bujqësore që ka komuna jonë, Drejtoria për EBZH ka për obligim që të përcjellë të gjitha mbjelljet, të mbajë statistika të këtij lloji dhe të ketë gjithmonë njohuri për orientimin dhe zhvillimin e vendit tonë në kulturat bujqësore.
13.	Korrje-shirjet				Korrik/gusht /2019	Në këtë aktivitet, organet komunale janë obligative që të përcjellin procesin,të ndajnë territorin e autokombajnave, të caktojnë komisionin për mbikëqyrje, të mbledhin statistika, ndërsa listën e autokombanjerëve dhe të rendimentit duhet ta dërgojnë në MBPZHR.
14.	Subvencionimi i kulturave lavërtare			MBPZHR	Pranverë/ vjeshtë/2019	Subvencionimi i grurit, misrit, sojës dhe lulediellit, si dhe të gjedheve, deleve, dhive, bletëve bëhet në çdo vit, dhe në bazë të praktikës së deritanishme ka filluar kryesisht në stinën pranverë ose vjeshtë.

15.	Grantet në bujqësi			MBPZHR	Pranverë/verë/2019	Thirrja për aplikim në grante në degët e bujqësisë tani po bëhet në çdo vit dhe në bazë të praktikës së deritanishme kryesisht në stinën pranverë ose verë.
16	Pastrime				Pranverë/vjeshtë/2019	Planifikohet që të bëhet pastrimi i pishave në Bukosh, projekt i Agjencionit të pyjeve
	GJITHSEJ:	475.000 €				

Në detajet buxhetore, prioritet janë të orientuara në:

- Bujqësia - në çdo vit vërehet dukshëm një orientim i madh i fermerëve në ndërtim të serrave me qëllim të kultivimit të perime-kulturave. Veçmas dallohet kultivimi i specave, domates dhe kornishonit (trangujve të vegjël). Ky investim në serra për fermerët tonë është një burim i mirë për një mirëqenie më të mirë familjare duke gjeneruar të hyra. Vlerësohet që investimet në projekte të tilla zbusin papunësinë, krijojnë të hyra për fermerët tonë dhe të gjithë qytetarët kanë mundësi të shërbehen me produkte kualitative, më të freskëta, por edhe me çmime më të lira për faktin se nuk i nënshtrohen importit. Këto aktivitete bujqësore rrisin numrin e ekonomive familjare.
- Realizimi i projektit për rregullim të bademeve (bankinës) është projekt shumë kapital dhe afatgjatë. Rëndësia e këtij projekti qëndron në faktin që komuna në vitin 2011 ka filluar me projektin e parë në këtë drejtim dhe për synim kemi parandalimin e vërshimeve nga reshjet në tokat bujqësore. Gjatë viteve lumi “Silnica” si rezultat i reshjeve të mëdha në disa vende ka devijuar rrjedhën, ndërsa në shumë raste është afër shpërthimit në toka me mbjellje të kulturave të ndryshme, veçmas patates. Investimet në këtë projekt kursejnë qindra-mijëra euro nga xhepat e fermerëve. Është projekt me kosto të lartë financiare, por mendohet që gradualisht në çdo vit të kemi mjete buxhetore të planifikuara për këtë projekt dhe të rregullohen të gjithë bedenat, me prioritet pikat më emergjente.
- Ditët dhe mundësitë promovuese, mbeten prioritet me rëndësi në kuadër të aktiviteteve tona. Në këtë drejtim dëshirojmë që të japim mundësi më shumë fermerëve me qëllim rritjen e tregut bizneseve, zgjerimin e kapaciteteve, njëkohësisht edhe komunës përmes pjesëmarrjes në panaire të ndryshme, në mënyrë që të tregojmë potencialet dhe mundësitë tona.
- Pyjet në komunën tonë, ashtu si në gjithë territorin e Kosovës nuk janë në gjendje të mirë. Si rezultat i pranimi të kompetencave nga MBPZHR dhe me qëllim mbrojtjen dhe kujdesin ndaj pyjeve, llogarisim se na duhet të ndërmarrim hapa konkret në këtë drejtim.

Shërbimet Publike

Buxheti për investime kapitale me të cilin menaxhon Drejtoria e Shërbimeve Publike ka vlerën **1,362,738.00 €**. Në tabelat e mëposhtme është paraqitur në mënyrë të detajuar plani i punës i Drejtorisë për Shërbime Publike.

	Aktiviteti	Periodha	Në bashkëpunim me:
1	Përgatitja e dokumentacionit dhe mirëmbajtja dimërore e rrugëve lokale.	Janar-mars	Policinë e Kosovës
2	Konkursi për ndarjen e linjave për transportin urbano-periferik të udhëtarëve, reduktimi dhe sistemimi i kombibusëve, si dhe vendosja e tyre në ndonjë vendparkim.	Janar-shkurt	Bashkëpunimi me pronarët e kombibusëve, Drejtorinë për Inspektive
3	Mirëmbajtja e kanalizimit atmosferik dhe i kanaleve të hapura.	Mars-prill	
4	Analiza e rrjedhës së qarkullimit të mjeteve motorike në bazë të senseve (kaheve) të lëvizjes në të gjitha rrugët e qytetit.	Mars-prill	Bashkëpunimi me Policinë e Kosovës, SHMT
5	Plani i aktiviteteve për shënimin e muajit të higjienës.	Mars-prill	Drejtorinë për Inspektive, KRH “Uniteti” dhe OJQ.
6	Mirëmbajtja e varrezave.	Prill-maj	
7	Mirëmbajtja (mirëmbajtja verore - plani i fshirje – larjes së rrugëve në qytet, mirëmbajtja e varrezave të qytetarëve, martirëve dhe dëshmorëve, mirëmbajtja dimërore).	Mars	Drejtorinë për Buxhet, Thesar dhe Financa dhe Drejtorinë për Prokurim
8	Eliminimi i deponive ilegale.	Shkurt- mars	Drejtorinë për Shërbime Publike
9	Përgatitja e dokumentacionit teknik për tenderim – paramasat dhe parallogaritë për shërbimet tjera kontraktuese.	Mars	Drejtorinë për Buxhet, Thesar dhe Financa, si dhe Drejtorinë për Prokurim
10	Implementimi i një projekti në kuadër të Planit të mobilitetit-lëvizshmërisë për të gjithë pjesëmarrësit në komunikacion.	Mars-prill	Spektori për komunikacion
11	Plotësimi dhe ndryshimi i Rregullores për sigurinë në komunikacion në territorin e Komunës së Vushtrisë, harmonizimi i saj me Ligjin për Sigurinë në Komunikacion, Ligjin për Rrugët, Ligjin për Transportin etj.	Qershor	Drejtorinë e Inspeksioneve, Policinë e Kosovës
12	Punë të ndryshme administrative për përgatitjen dhe organizimin e kompanive për transportin publik gjatë vitit shkollor.	Gusht	Kompanitë transportuese
13	Përgatitja e paramasave dhe parallogarive për riparimin dhe mirëmbajtjen e mjeteve motorike të K. Komunës.	Gjatë tërë vitit, sipas nevojës	Drejtorinë për Buxhet, Thesar dhe Financa dhe Drejtorinë për Prokurim

14	Përgatitja e paramasave për furnizim me goma për mjetet motorike të Komunës.		Drejtorinë për Buxhet, Thesar dhe Financa dhe Drejtorinë për Prokurim
15	Përgatitja e dokumentacionit për sigurimin dhe regjistrimin e automjeteve të komunës.	Gjatë tërë vitit, sipas nevojës	Drejtorinë për Buxhet, Thesar dhe Financa dhe Drejtorinë për Prokurim
16	Përgatitja e dokumentacionit për furnizim me derivate, lëndë djegëse dhe vajra për vetura, për mjetet motorike të komunës.	Gjatë tërë vitit, sipas nevojës	Drejtorinë për Buxhet, Thesar dhe Financa dhe Drejtorinë për Prokurim
17	Implementimi i objektivave të Planit komunal pesëvjeçar të menaxhimit të mbeturinave.	Gjatë tërë vitit, sipas nevojës	KRH "Uniteti" SH.A.
18	Dekorimi i hapësirave në qytet.	Nëntor-dhjetor	Drejtorinë për Buxhet, Thesar dhe Financa, si dhe Drejtorinë për Prokurim
19	Përgatitja e raportit për vitin 2019 dhe përgatitja e planit për vitin 2020.	Dhjetor	

Planifikimi i projekteve kapitale në Drejtorinë e Shërbimeve Publike të aprovuara nga Kuvendi Komunal për vitin 2019
Vlera1,336,998.00 €

1	Aktiviteti	perioda	Vlera e projektit	Pjesëmarrës tjetër
2	Përgatitja e dokumentacionit teknik për tenderim – paramasa dhe parallogaria për ndërtimin e parqeve (mbjellja e drunjve dekorativ).	Janar-shkurt	20,000.00	Drejtoria për Shërbime Publike
3	Hartimi i paramasës dhe parallogarisë për ndërtimin e vendparkingjeve publike.	Shkurt-mars	10,000.00	Drejtoria për Shërbime Publike
4	Përgatitja e dokumentacionit teknik për tenderim – paramasa dhe parallogaria për ndërtimin e trotuareve.	Prill	77,000.00	DBTHF dhe Drejtorinë për Prokurim
5	Blerja e kontejnerëve për mbeturina.	Shkurt	15,000.00	

6	Projekti për ndërtimin e stacionit të autobusëve.	Mars-prill	25,000.00	
7	Implementimi i kontratës për ndërtimin e urës në Dobërllukë.	Mar-qershor	80,000.00	DUMM, DBTH Drejtoria për Prokurim
8	Implementimi i kontratës kornizë për sinjalizim horizontal dhe vertikal.	Janar	40,000.00	DBTHF dhe Dre për Prokurim
9	Përgatitja e dokumentacionit teknik për tenderim – paramasa dhe parallogaria për ndërtimin e kanalizimeve.	Mars	250,738.00	DUMM, DBTH Drejtoria për Prokurim
10	Ndërtimi i urave dhe mureve mbrojtëse.	Mars	25,000.00	DBTHF dhe Dre për Prokurim
11	Përgatitja e dokumentacionit teknik për tenderim – paramasa dhe parallogaria për ndriçim publik .	Prill	5,000.00	DBTHF dhe Dre për Prokurim
12	Implementimi i kontratës për rekonstruktimin e rrugëve të asfaltuara .	Gjatë tërë vitit	120,000.00	
13	Implementimi i kontratës për ndërtimin e rrugëve të rendit të IV-të.	Gjatë tërë vitit	35,000.00	
14	Zgjerimi i rrjetit të ujësjellësit.	Maj	150,000.00	DBTHF dhe Dre për Prokurim
15	Përgatitja e dokumentacionit teknik për tenderim – paramasa dhe parallogaria për ndërtim të rrugëve me kubëza betoni.	Prill	195,000.00	DBTHF dhe Dre për Prokurim
16	Rregullimi i lumit “Tërstena”.	Maj	10,000.00	
17	Rregullimi i varrezave të martirëve në fshatin Galicë dhe qytet.	Shkurt	10,000.00	
18	Ndërtimi i tregut për prodhues vendorë.	Korrik	25,000.00	Donatorët
19	Ndërtimi i Sheshit „Ahmet Krasniqi”.	Shkurt	40,000.00	DUMM
20	Ndërtimi i shtratit të lumit „Podranqa”.	Mars-qershor	50,000.00	DUMM

Në bazë të planifikimit për të hyra vetanake për vitin 2019, Drejtoria e Shërbimeve Publike do të hartojë një strategji për realizimin e planit të të hyrave vetanake nga: parkingjet, ndaljet e mjeteve për ngarkim-shkarkim, shërbimet me automerimangë, regjistrimi i mjeteve motorike, shfrytëzimi i trotuareve për ndërtime dhe renovime të ndryshme, reklamat, vërtetimet e rendeve të udhëtimit, pëlqime tjera.

Arsimi

Prioritetet kryesore të DA-së janë:

- Mësimdhënie dhe mësimnxënie bashkëkohore;
- Përgjegjësi dhe llogaridhënie;
- Cilësia dhe kurrikula e re, për zhvillim të qëndrueshëm;
- Shkolla autonome me vlerësueshmëri;
- Ofrimi i praktikave profesionale;
- Partneritet me standarde të reja.

Nr.	Objektivat	Aktivitetet	Financuar në euro	Afati	Bartësit e aktiviteteve	Ndërlidhja me akt tjera
1	<i>Kushte bashkëkohore për mësimdhënie dhe mësimnxënie efektive</i>	1.1.Ndërtimi i objektit të ri të SHFMU “Bajram Curri” Dumnicë e Llugës	135. 841.74 euro	JANAR- DHJETOR	• DA, • Drejtoria e Prokurimit, • DUMM	Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë 2017-2021
		1.2.Ndërtimi i objektit të ri SHFMU “Migjeni” Stanoc i Epërm	134.572 euro	JANAR DHJETOR (Projekt trevjeçar)	• DA, • Drejtoria e Prokurimit, • DUMM	Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë 2017-2021
		1.3.Furnizimi i shkollave me inventar	50.000 euro	JANAR DHJETOR	• DA, • Drejtoria e Prokurimit, • DUMM	Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë 2017-2021

	1.4. Ndërtimi i çerdhes së re	50.000 euro	JANAR DHJETOR 18 (Projekt trevjeçar)	• DA, • Drejtoria e Prokurimit, • DUMM	Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë 2017-202
	1.5.Ndërtimi i sallave sportive	100.000 euro	JANAR-DHJETOR	• DA, • Drejtoria e Prokurimit, • DUMM	Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë 2017-202
	1.6. Meremtimi i shkollave	130.000 euro	JANAR - DHJETOR	• DA, • Drejtoria e Prokurimit, • DUMM	Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë 2017-202
	1.7.Vazhdimi i ndërtimit të çerdhes projekt trevjeçar	14.227 euro	JANAR - DHJETOR	• DA, • Drejtoria e Prokurimit, • DUMM	Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë 2017-2021
	1.8.Ndërtimi i nxemjes qendore në SHFMU- Lumadh	10.000 euro	JANAR-DHEJTOR	• DA, • Drejtoria e Prokurimit, • DUMM	Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë 2017-2021
	1.9.Ndërtimi i shkollës së muzikës	100.000 euro	JANAR-DHEJTOR	• DA, • Drejtoria e Prokurimit, • DUMM	Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë 2017-2021
	1.10.Fusha sportive	60.000 euro	JANAR – DHEJTOR	• DA, • Drejtoria e Prokurimit, • DUMM, Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë 2017-2021	Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë 2017-2021

		1.11.Pajisje me TIK	50.000 euro	JANAR-DHEJTOR	• DA, • Drejtoria e Prokurimit, • DUMM	Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë 2017-202
		1.12. Pajisje laboratorike	10.000 euro	JANAR - DHJETOR	• DA, • Drejtoria e Prokurimit, • DUMM	Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë 2017-202
		1.13.Transporti i nxënësve	I mbetet kuvendit ta përcaktojë shumën	JANAR - QERSHOR-SHTATOR-DHJETOR	• Zyrtarët e DA-së	Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë 2017-202
		1.14.Transporti i nxënësve me nevoja të veçanta	I mbetet kuvendit ta përcaktojë shumën	JANAR - QERSHOR-SHTATOR-DHJETOR	• Zyrtarët e DA-së	Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë 2017-202
2	<i>Koordinimi i bërmbashkët dhe përkrahja për rritjen e përgjegjësisë individuale e kolektive</i>	2.1. Monitorimi i mirëmbajtjes së pastërtisë në shkolla	Pa kosto	JANAR-DHJETOR	• Zyrtarët e DA-së	Ligji i Arsimit Parauniversitar/ Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë 2017-2021
		2.2. Monitorimi i sigurimit të objekteve shkollore	Pa kosto	JANAR-DHJETOR	• DA, • Drejtoria e Prokurimit	Ligji i Arsimit Parauniversitar
		2.3. Monitorimi i shpenzimeve komunale në secilën shkollë të komunës	Pa kosto	JANAR - DHJETOR	• Zyrtarët e DA-së	Ligji i Arsimit parauniversitar/ Liq për menaxhimin e financave publike
		2.4. Mentorimi i shkollave të tri niveleve	Pa kosto	JANAR - DHJETOR	• Zyrtarët e DA-së, • SLA- Mitrovicë	Ligji i arsimit parauniversitar

3	Sigurimi dhe zhvillimi i cilësisë dhe zbatimi i KK-së	3.1. Vlerësimi i 15 shkollave për 2 fusha të cilësisë dhe 9 shkollave për 5 fusha të cilësisë; 3.2. Trajnimi për koordinatorët e shkollave tjera; 3.3. Monitorimi i vlerësimit të cilësisë; 3.4. Funksionimi i koordinatorëve të cilësisë; 3.5. Vlerësimi i jashtëm i shkollës.	Pa kosto	JANAR-DHJETOR	• Zyrtarët e DA-së, • MASHT, • Instituti Pedagogjik –Prishtinë, • Sektori i inspektimit Mitrovicë	Plani Zhvillimor Komunal i Arsimit UA.Nr.24/2016 PËR SIGURIM T CILËSISË NË ARSIMIN PARAUNIVERSITAR
		3.6. Vazhdimi i trajnimit të mësimeve komfor kurrikulës së re, përkrahja dhe mbështetja e mësimeve	Pa kosto	JANAR - DHEJTOR	• Zyrtarët e DA-së • Trajnerët e KK-së	Korniza e Kurriku e Arsimit Parauniversitar
		3.7. Monitorimi i planave vjetore, detyrime dhe ditore sipas KK-së	Pa kosto	JANAR - DHJETOR	• Zyrtarët e DA-së	Korniza e Kurriku e Arsimit Parauniversitar
		3.8. Vlerësimi i dosjeve të mësimeve	Pa kosto	SHKURT-MARS	• Zyrtarët e DA-së	Korniza e Kurriku e Arsimit Parauniversitar
		3.9. Organizimi i garave të ndryshme artistike, kulturore dhe sportive	Pa kosto	MARS - QERSHOR	• Zyrtarët e DA-së me mësime, si dhe shoqata e pedagogëve të kulturës fizike dhe sportit shkollor	Plani zhvillimor Komunal i Arsimit në Vushtrri
		3.10. Organizimi i olimpiadës së matematikës	Pa kosto	MARS-MAJ	• Zyrtarët e DA-së me mësime	Kalendari i Shoqatave të Matematikanëve të Kosovës

		3.11. Nxjtja e nxënësve dhe promovimi i dijes në olimpiada që mbahen jashtë komunës dhe stimulimi	Pa kosto	MARS - QERSHOR	• Zyrtarët e DA-së	Plani zhvillimor Komunal i Arsimit në Vushtrri
		3.12. Organizimi i kuizit të historisë, për nder të 17 Shkurtit “Ditës së Pavarësisë”	Pa kosto	SHKURT	• Zyrtarët e DA-së, • profesorët e historisë	Plani zhvillimor Komunal i Arsimit në Vushtrri
		3.13. Organizimi i garës me poezi dhe pikturë për nder 5.6.7.8 Marsit	Pa kosto	MARS	• Zyrtarët e DA-së, • profesorët e arit dhe gjuhës shqipe	Plani zhvillimor Komunal i Arsimit në Vushtrri
4	<i>Vlerësimet e jashtme</i>	4.1.Organizmi i provimit të maturës shtetërore 2019, 4.2. Analiza e testit të maturës	Pa kosto	QERSHOR-SHTATOR	• DA	Ligji Nr. 03/L-018 PËR PROVIMIN PËRFUNDIMTAJ DHE PROVIMIN MATURËS SHTETËRORE
		4.3. Organizimi i testit të arritshmërisë 2019, 4.4. Analiza e testit të arritshmërisë	Pa kosto	QERSHOR-SHTATOR	• DA	Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë 2017-2021
		4.5.Analiza e testit PISA (vlerësimi ndërkombëtar), 4.6. Aanaliza e testit TIMSS, 4.7. Vlerësimi sipas shkallës së KK	Pa kosto	QERSHOR PRILL DHJETOR	• DA, • MASHT	
	<i>Menaxhimi i vendeve të lira të punës</i>	5.1. Përgatitjet për shpalljen e konkursit për vendet e lira të punës për mësimdhënës	Pa kosto	JANAR-DHJETOR	• DA	Ligji i arsimit parauniversitar UA.Nr10/2018 UA. Nr 7/17

5		5.2. Përgatitja për shpalljen e konkursit për drejtorë dhe zëvendës drejtorë të shkollave.	Pa kosto	JANAR-DHJETOR	• DA, • ZYRA E PERSONELIT, • MASHT	UA.Nr.08 /2014. Përzgjedhja e drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve
		5.3. Analiza e normave të mësimdhënësve		MAJ-QERSHOR	• DA	
6	<i>Arsim për të gjithë</i>	6.1. Përfshirja e gjithë nxënësve në arsim pa marrë parasysh gjuhën dhe etninë	Pa kosto	JANAR-DHJETOR	• DA, • MASHT	Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë 2017-2021 /STRATEGJIA PËR INTEGRIMIN E KOMUNITETEVE ROMË, ASHKAL DHE EGJIPTIAN NË KOSOVË - KOMPONENTA 1 EDUKIMIT 2007-2017
		6.2. Funksionimi i ekipit për vlerësimin e nxënësve me nevoja të veçanta arsimore	Pa kosto	JANAR-DHJETOR	• DA, • MASHT	UA.Nr.16 /Vlerësimi pedagogjik i fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore
		6.3. Objekte të qasshme për nxënës me nevoja të veçanta	Pa kosto	JANAR-DHJETOR	• DA	Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë 2017-2021
		6.4. Ofrimin, motivimin, këshillimin, sugjerimin, si dhe marrjen e masave për integrimin e nxënësve me nevoja të veçanta arsimore në klasat e rregullta dhe ofrimin e asistentëve për fëmijë me nevoja të veçanta (2 ose 3)	Pa kosto	JANAR - DHJETOR	• DA, • MASHT	Vlerësimi profesional i fëmijëve me nevoja të veçanta edukative- arsimore Nr.07.2012

		6.5.Përfshirja progresive e nxënësve parashkollorë në shkollat e papërfshira	Pa kosto	JANAR-DHJETOR	• DA	Ligji mbi Edukim Parashkollor Nr.02/L-52
		6.6. Identifikimi i rasteve të braktisjes, 6.7.Vlerësimi i nxënësve që braktisin shkollën, 6.8. Riintegrimi në shkolla	Pa kosto	JANAR-QERSHOR/SHTATOR – DHJETOR	DA, Qendra për punë sociale, policia për komunitet, MASHT	UA-Nr.19/2012 Fuqizimi i ekipeve për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes dhe mosregjistrim në arsimin e obliguar
7	Praktikat profesionale, hap i rëndësishëm për punësim dhe orientim në karrierë	7.1.Bashkëpunimi me ndërmarrje punuese, angazhimet për kryerjen e praktikave	Pa kosto	SHKURT-DHJETOR	• DA, • Ndërmarrje	Strategjia për përmirësimin e praktikës profesionale në Kosovë 2013/2020 Nr.01B-101
		7.2. Organizimi i javës të dyerve të hapura për nxënësit e klasave të IX-ta, 7.3.Ndarja e fletushkave për klasat e IX-ta, 7.4.Kremtimi i ditës së vajzave	Përcaktohet në bazë të numrit të nx.	JANAR-DHJETOR	• DA, • Qendra e karrierës	Korniza e Kurriku e Arsimit Parauniversitar
8	Bashkëpunimi dhe ndërveprimi	8.1. Koordinimi i aktiviteteve, 8.2. Pjesëmarrje në debate, 8.3. Identifikimi i nevojave të përbashkëta	Pa kosto	JANAR-DHJETOR	• Këshilli i prindërve, • OJQ, • KFOR, • FSK, • Policia	Plani zhvillimor komunal i arsimit i Vushtrri

Urbanizëm dhe mbrojtje të mjedisit

Në kuadër të investimeve në Planifikim Mjedisor investohet kryesisht për asfaltim të rrugëve lokale në Komunën e Vushtrrisë, për investime të tilla ka në dispozicion një buxhet në shumën prej 1,459,790.00€ .Më poshtë janë shënuar Aktivitetet për të cilat DUMM ka planifikuar - Planin e Punës për vitin 2019:

Nr. Shtesa	Emri i funksionit	Periudha	Kushtetuesit	Vendndërimi
1	Zbatimi i Ligjeve në fuqi, udhëzimeve administrative dhe akteve tjera nënligjore që kanë të bëjnë me Drejtorinë e Urbanizmit dhe Planeve Hapësinore	Janar - Dhjetor	Me të gjitha drejtoritë komunale që lidhet puna dhe aktiviteti i drejtorisë.	Zyra Ligjor
2	Menaxhimi i kërkesëve për dhënjën e Kushteve Ndërtimore dhe Protokollit të rregullimit, Pelqimeve Urbanistike	Janar-Dhjetor	Me Drejtorinë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, Drejtorinë e Bujqësisë Drejtorinë e Inspektionit	Spektori Urbanizmit
3	Menaxhimi i kërkesëve për dhënjën e Lejeve Ndërtimore si dhe caktimi i pikave të ndërtimit sipas Lejeve Ndërtimore	Janar - Dhjetor	Me Drejtorinë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, Drejtorinë e Bujqësisë Drejtorinë e Inspektionit	Spektori Urbanizmit Planifikimit
4	Inicimi i procedurave për afstaltimin e rrugëve të aprovuara nga Kuvendi Komunal Vushttri sipas Planit Zhvillimor Komunal	Janar - Dhjetor	Me drejtorinë e Financave, Drejtorinë e Prokurimit dhe Drejtoritë tjera.	Spektori i Planifikimit
5	Mbikëqyrja e projekteve kapitale të Komunës	Janar - Dhjetor	Me Drejtorinë e Financave dhe Drejtorinë e Prokurimit	Spektori i Planifikimit
6	Menaxhimi i Sistemit të Adresave në të gjithë territorin e komunës si në qytet ashtu edhe në fshatra, duke përfshirë në sistem edhe menaxhimin e kërkesave të ndryshme për ndryshime të kërkuara	Janar - Dhjetor	Me të gjitha Drejtoritë dhe Institucionet tjera relevante	Spektori për sistemin e Adresave
7	Ndihmon në kujdesin për mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore brenda territorit të Komunës së Vushttrisë	Janar - Dhjetor	Drejtorinë për Kulturë dhe Entin për Mbrojtjen e Monumenteve Kulturo-historike të Kosovës	Spektori Urbanizmit

8	Hartimi i Hartës Zonale të Komunës së Vushtrrisë bazuar në PZHK 2016-2024	Janar - Dhjetor	Me të gjitha Drejtoritë dhe Institucionet tjera relevante	
---	---	-----------------	---	--

Në kuadër të planifikimit urban dhe mjedisit, janë planifikuar asfaltimet e rrugëve lokale dhe atë siç vijon:

660	Planifikimi urban dhe mjedisi
66425	Planifikimi mjedisor dhe inspektimet
41424	Ndërtimi i rrugëve lokale në fshatra
43910	Hartimi i projekteve
45592	Asfaltimi i rrugëve në Reznik (lagjja “Mustafa, Curri, Makiqi”) dhe në Shalle
41423	Hartimi i hartës zonale
45632	Asfaltimi i rrugës Vushtri-Nedakoc-Pestovë
45265	Asfaltimi i rrugëve në qytet
	Asfaltimi i rrugëve në 17 fshatra

Realizimi i të hyrave të planifikuara për vitin 2019

Në bazë të planifikimit për të hyrat vetanake për vitin 2019, Drejtoria e Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit do të hartojë një plan për realizimin e të hyrave vetanake nga:

- Mjetet që inkasohen në rastin e lëshimit të lejeve e ndërtimore;
- Mjetet që inkasohen nga dhënia në shfrytëzim e tokës në pronësi të komunës në afatshkurtër dhe afatgjatë;
- Mjetet që inkasohen nga lëshimi i lejeve mjedisore komunale;
- Mjetet që inkasohen nga legalizimi i objekteve të ndërtuara pa leje (është proces që pritet të fillojë gjatë vitit);
- Mjetet që inkasohen nga instalimet e ndryshme nëntokësore dhe mbitokësore;
- Mjetet që inkasohen nga lëshimi i pëlqimeve të ndryshme urbanistike... etj.

Për realizimin e planifikimit për të hyrat vetanake të përshkruara me lartë, përpos angazhimit të stafit që janë bartësit kryesor, janë edhe drejtoritë tjera relevante në Komunën e Vushtrrisë, ndërsa në faktorët tjerë që kanë ndikim negativ në mosrealizimin e synimeve të cekura më lartë ka edhe shumë faktorë tjerë, siç mund të jenë:

- Pamundësia e stimulimit të punëtorëve gjatë kryerjes së punëve të tyre, gjatë orarit të punës, e sidomos puna jashtë orarit të regullt dhe gjatë vikendeve;
- Mungesa e dokumentacionit relevant të plaçkitur gjatë dhe para luftës nga okupatori serb;
- Mungesa e stafit - ekspertëve përkatës në këtë drejtori.

Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale

Objektivat e përgjithshme:

- Ofrimi i kujdesit shëndetësor për qytetarët e Komunës së Vushtrrisë përmes zbatimit të konceptit të mjekësisë familjare në kuadër të sistemit unik shëndetësor të Kosovës;
- Edukimi shëndetësor si: Parandalimi i sëmundjeve, imunizimi dhe vaksinimi;
- Përcaktimi i diagnozës fillestare dhe kujdesi elementar shëndetësor, duke përfshirë edhe ndërhyrjet e vogla kirurgjike;
- Kujdesin shëndetësor riprodhues dhe planifikimi familjar;
- Kujdesi shëndetësor ndaj nënës, fëmijës dhe adoleshentëve;
- Kujdesin për shëndetin mendor të bazuar në bashkësi, rehabilitimi;
- Zbulimi i hershëm i sëmundjeve ngjitëse dhe raportimi i tyre;
- Promovimi i shëndetit oral dhe kujdesi themelor stomatologjik;
- Ofrimi i shërbimeve shëndetësore diagnostike; analizave laboratorike dhe imazheve rëntgenologjike në kuadër të kujdesit parësor shëndetësor;
- Vizitat sistematike për nxënësit;
- Zhvillimi i vazhdueshëm profesional i personelit shëndetësor;
- Menaxhimi sa më i mirë dhe shpërndarja e barërave në KPSH;
- Kujdesi për të sëmurët me sëmundje kronike, si dhe ata që gjenden në stadin terminal të sëmundjes;

- Rritja e të hyrave, duke rritur përgjegjësinë për mbledhjen e këtyre të hyrave, si dhe menaxhimi sa më i mirë i fondeve të dedikuara për KPSH.

OBJEKTIVAT	REALIZIMI I OBJEKTIVAVE – BARTËSIT	PLANIFIKIMI I REALIZIMIT
Mjekësia familjare ka qëllim prioritar përmirësimin e cilësisë së punës. Pas instalimit të menaxhimit të rendit që ka dhënë efekt të rëndësishëm, caktimi i termineve për vizita mjekësore i cili do të fillojë së shpejti, në ç'rast pacienti do të caktojë termin për vizitë, ai do të ketë mundësinë edhe të zgjedhë mjekun. Që të kemi zonim të shërbimeve për qytetarët, për qasje më të lehtë dhe marrjen e shërbimeve më cilësore duhet që mjeku dhe infermierja së paku 5 ditë të javës të punojë në QMF. Kjo do të ketë ndikim në zvogëlimin e fluksit të pacientëve, sidomos në QKMF dhe QMF1, ku orari i punës është 12 h në ditë. Nëse arrihet zonimi i marrjes së shërbimeve, atëherë duhet të fillojmë me ndarjen e pacientëve për mjekë.	Koordinatorja e cilësisë, përgjegjësit e mjekësisë familjare, kryeinfermierja e QKMF-së, stafi i mjekësisë familjare Drejtori Zv.drejtori, koordinatorja e cilësisë, përgjegjësit e mjekësisë familjare, kryeinfermierja e QKMF-së, stafi i mjekësisë familjare	Fillon nga muaji janar deri në përfundim të vitit. Fillon nga muaji janar deri në përfundim të vitit, dhe vazhdon në vitet e ardhshme. Me një vlerësim të gjendjes pas gjashtëmujorit të parë të vitit.
Edukimi i vazhdueshëm profesional për mjekë dhe për infermierë, bëhet edhe për sëmundjet më të shpeshta që paraqiten te qytetarët. Po ashtu edhe për nxënës të shkollave fillore dhe adoleshentë mbahen ligjërata të përmujshme për veset e ndryshme dhe	QKMF, ZHVP, EVI, QTI	Përgjatë gjithë vitit kalendarik Që nga muaji janar deri në dhjetor, me një pauzë dymujore gjatë pushimeve të verës.

sëmundjet që i atakojnë me shpesh adoleshentët.		
Shërbimi stomatologjik do të ofrohet gjatë 24 h. nëse na lejojnë mundësitë buxhetore. Si menaxhment kemi synim rritjen e numrit të stomatologëve në mënyrë që përveç në qytet edhe në 3 QMF-të që gjenden në fshatrat me numër më të madh të pacientëve, të dërgojmë stomatologun dy ose tri herë në javë. Është me rëndësi që gjatë këtij viti, përgjegjësi i stomatologjisë me kolegët e tij të organizojë vizita për edukim të nxënësve në shkolla fillore, për mbajtjen e higjienës së gojës, si dhe preventivë kundër kariesit të dhëmbit.	DSHPS, QKMF Sektori i stomatologjisë, kirurgja orale, stomatologu, asistentët, infermierët	Që nga janari në dhjetor, duke ofruar shërbime stomatologjike për të gjithë qytetarët. Gjatë vitit nga janari në dhjetor

Shefi i laboratorit ka planifikuar që të shtojë numrin e analizave laboratorike që kërkohen me UA/ për KPSH. Shtimi i numrit të këtyrë analizave do të ndikojë në rritjen e kënaqshmërisë së pacientëve. Është planifikuar që laboratori të punojë në dy ndërrime, në mënyrë që qytetarët gjatë urgjencave të tyre të kenë mundësi që të marrin shërbime laboratorike në QKMF. Gjithashtu është kërkuar që të punohet edhe gjatë festave në formë të kujdestarisë. Paraprakisht duhet të na ofrohet një kosto financiare në mënyrë që ne të dimë se a do kemi mundësi buxhetore për mbulimin e këtij organizimi të punës, i cili ka një kosto të lartë financiare.	DSHPS, QKMF biokimisti, laborantët, infirmierët biokimisti, laborantët, infirmierët	Përgjatë gjithë vitit duhet siguruar servisim të aparatures dhe sasi të nevojshme të reagensave, me një specifikim të mirë që mos të vie deri te bllokimi i punës për shkak të neglizhencës apo për shkak të specifikimit jo të mirë të materialit shpenzues si dhe aparaturës. Punë e vazhdueshme gjatë gjithë vitit
Shërbimi i RTG ka planifikuar të furnizohet me CD dhe filma të Rtg. Kërkesa e tyre është që të kenë një hapësirë më të madhe për punë, ndërkaq për momentin kjo është jo e mundshme, po që mund dhe do të realizohet kur paraqitet mundësia e parë.	DSHPS, QKMF, shefi i diagnostikues, technikët e RTG-së infirmieret e trajnuara	Gjatë vitit 2019 nga janari në dhjetor, me vlerësim të punës në fillim të gjashtëmujorit të dytë të vitit 2019. Zhvillimi i punës gjatë gjithë vitit, duke mos lënë hapësirë për mungesë të materialit shpenzues.
Spektori i shëndetit publik- Përgjegjësi i shërbimit publik për çdo vit organizon vizita sistematike për nxënësit e klasëve të para, pesta dhe të nënta në të gjitha shkollat fillore në nivel komunë. Sipas planit këto vizita do të kryhen në semestrin e dytë shkollor të vitit 2019, kurse numri total i nxënësve të përfshirë në këto vizita	DSHPS, QKMF përgjegjësi i spektorit të shërbimit publik, koordinatori i SISH, përgjegjësjë e vaksinimit, M.F, përgjegjësi i spektorit të shërbimit publik,	Zakonisht këto vizita kryhen në prill për një pjesë të nxënësve, dhe në shtator kur nxënësit janë në proces të mësimin në mënyrë që të vizitohen të gjithë.

sistematike është 3.368 nxënës, më vonë do keni planin e detajuar të vizitave.	infermier dhe staf tjetër	
Këshillimorja për sëmundje kronike joinfektive, me theks të veçantë për diabet dhe hipertension, jep mundësi edukimi për preventivë më të mirë ndaj këtyre dy sëmundjeve të shpeshta, e po ashtu edhe vizita mjekësore dhe këshilla për të sëmurët në mënyrë që të përcillet gjendja e tyre dhe që të pengohen ndërlikimet e mundshme e që pacienti mund të përfundojë në invaliditet, e që ka kosto të madhe financiare për pacientin, familjen dhe shoqërinë.	DSHPS, drejtori, AQH, mjekët familjarë, infermieret e trajnuara për edukim dhe motivim për këto dy sëmundje.	Përgjatë gjithë vitit dhe në vazhdimësi, me qëllim që të kemi një edukim dhe vetdijësim të mirë për qytetarët në mënyrë që të redukohen pasojat e mëdha të këtyre sëmundjeve që ndërlikimet e tyre çojnë në invaliditet.
Vizita në shtëpi për gra shtatëzëna dhe fëmijë deri në moshën 5 vjeçare. Këto janë vizita të mirëseardhura për komunitetin e shumë dobiprurëse, sidomos për nënat e reja, të cilat këshillohen për kujdesin ndaj fëmijës së posalindur, duke e këshilluar për rëndësinë e gjidhënies për fëmijën dhe nënën gjithashtu. Vështërsi është mungesa e një automjeti që infermierëve u duhet për punë në terren.	DSHPS, drejtori, kryeshefja, kryeinfermjerja si koordinatorë e këtij projekti, kryeinfermjerja e QKMF-së, kryeinfermjerja e M.F, infermieret e trajnuara	Ka filluar në muajin nëntor të vitit 2018, dhe do të vazhdojë duke u zhvilluar çdo vit si projekt i rëndësishëm dhe i përcaktuar në detyrat e punës me udhëzim administrativ të KPSH-së. Në vazhdimësi
Urgjenca shërbim që ofrohet 24 h në ditë, është shumë i rëndësishëm për jetën e pacientit. Puna zhvillohet në dy ndërrime 12 orëshe. Në katër ekipe, ekipi përbëhet nga mjeku dhe 4 infermierë, ndërsa në ndërrimin e paraditës është në punë edhe mjeku që	DSHPS, QKMF, kryeshefja e QKMF-së	Janar -dhjetor Nga janari në dhjetor

është përgjegjës i urgjencës e po ashtu edhe kryeinfermieri i shërbimit. Kërkesë e përgjegjës të urgjencës është të kenë në ndërrimin e natës një ekip që është e përbërë nga dy mjekë dhe 4 infermierë. Kjo që të mund të realizohet sa më mirë shërbimi në urgjencë e sidomos në rastet kur paraqitet nevoja për shërbim në terren	përgjegjës i sektorit të urgjencës, kryeinfermieri i urgjencës	dhe në vazhdimësi
BARNATORJA në të bëhet grumbullimi, ruajtja dhe distribuimi i barnave nga Ministria e Shëndetësisë në depon qendrore, e nga aty në të gjitha njësitet organizative të QKMF-së. Ky distribuim bëhet në 20 qendra shëndetësore e që realizohet përmes QKMF-së. Gjatë tërë vitit përgjegjësi (farmacisti) duhet t'i monitorojë njësitet ku shpërndahen barnat dhe personat përgjegjës, për të përcjell hyrje-daljet e barnave, ruajtjen e tyre, afatin e përdorimit etj. Për gjashtëmujorin e parë të vitit 2019 janë planifikuar 106.129.38 euro, medikamente dhe material shpenzues, pjesa më e madhe e kësaj shume është e destinuar për insulina, ndërsa nga buxheti komunal e kemi kontratën kornizë dyvjeçare, e që është valide edhe për vitin 2019. Gjithsej për dy vite buxheti i kontratës ka qenë 18.263.00 euro. Përgjegjësi i barnatores ka kërkuar një punëtor (teknik të farmacisë) në depon	DSHPS, QKMF, përgjegjësi i depos qendrore-farmacisti, tekniku i farmacisë, infermierja në farmaci dhe të gjitha infermieret tjera në shpërndarje të barnave Infermierët e njësive të ndryshme të QKMF-së, në QMF dhe në AMF	Gjatë gjithë vitit Planifikimi bëhet për janar qershor dhe dhe korrik –dhjetor. Për pjesën e parë dhe të dytë të vitit 2019

qendrore, që të realizohen punët sa më mirë në këtë sektor, pasi që ka shumë kërkesa për barna nga njësitë organizative dhe ka ngarkesë pune.

Projektet

Programi	Emri i projektit	Plani i prokurimit 2019	Shuma e projektit
0721	Rregullimi i oborreve dhe hapësirave të QMF-ve dhe AMF-ve	Shkurt 2019	50 000
0721	Teknologji informative	Maj 2019	10 000
0721	Renovimi i QMF-ve dhe instalimi i ngrohjeve me pelet	Mars 2019	80 000
0721	Ndërtimi i QMF-së në Vushtrri	Prill 2019	85 000
0721	Rregullimi i kulmeve në AMF	Maj 2019	20 000
0721	Pajisje mjekësore	Prill 2019	45 336
0721	Furnizim me inventar	Qershor 2019	25 045
0721	Ndërtimi i zyrave për administratën e shëndetësisë	Janar 2019	105 000

Qendra për punë sociale - Projektet

Programi	Emri i projektit	Plani i prokurimit 2019	Shuma e projektit
1040	Renovimi i objektit	Prill 2019	3000

Qendra rezidenciale - Projektet

Programi	Emri i projektit	Plani i prokurimit 2019	Shuma e projektit
1060	Renovimi i objektit të shtëpisë rezidenciale	Prill 2019	5000

Inspektimet

Inspektorati i tregut

	Aktiviteti	Bartësit e aktiviteteve	Planifikimi i realizimit	Lokacioni
1	Inspektimi: • I subjekteve hoteliere dhe subjekteve tjera tregtare, • I regjistrimit të biznesit, i subjekteve të reja afariste • I vendosjes së çmimeve, saktësia e çmimeve e deklaruar, • I respektimit të orarit të punës, • I të gjitha subjekteve afariste që bëjnë transportimin e mallrave nga subjekti tek subjekti, • I kualitetit dhe siguria e produkteve -udhëzimet teknike, garancinë e mallrave, si dhe saktësia e dokumentacionit përcjellës etj, • I afatit të përdorimit të mallrave, • I kushteve teknike të subjekteve afariste tregtare që merren me shumicë dhe pakicë dhe subjektet shërbyese, zejtare etj, • I peshojave (kalibrimi i tyre), • Shqyrtimi i kërkesave eventuale.	Inspektorati i tregut	JANAR -DHJETOR	Të caktuar sipas prioritetit në bashkëpunim me drejtorin e drejtorisë

Inspektorati sanitar

	Aktiviteti	Bartësit e aktiviteteve	Planifikimi i realizimit	Lokacioni
	<u>Inspektimi i bizneseve lidhur me:</u> - Kushtet teknike të subjekteve afariste tregtare që merren me shumicë dhe pakicë dhe subjektet shërbyese etj. - Subjektet shërbyese (librezat sanitare, uniformat e punëtorëve. - Përcjelljen e analizave të ujit të pijes nga rezervuari i ujit. - Pranimin dhe shqyrtimin e kërkesave eventuale. - Respektimin e Ligjit për kontrollin e duhanit tek subjektet afariste dhe institucionet publike	Inspektorati Sanitar	Janar -dhjetor	Të caktuar sipas prioritetit bashkëpunim me drejtorin drejtorisë

Për të gjitha subjektet të cilat veprojnë në kundërshtim me ligjet në fuqi dhe rregulloret komunale do të inicohet procedura për kundërvajtje në Gjykatën themelore.

Inspektorati i ndërtimtarisë

Nr.	Aktiviteti	Bartësit e aktivitetit	Bashkëpunimi me subjekte tjera relevante	Planifikimi
1	Marrjen e të gjitha masave ligjore në rast të mospërfilljes së ligjeve dhe rregulloreve komunale të cilat janë të aplikueshme nga organi kompetent, për persona të cilët kryejnë ndërtime pa leje.	Inspektorët e ndërtimit	Drejtorinë për Planifikim Hapësinor	Gjatë tërë vitit

2	Në bazë të Ligjit Nr.04/L – 110, të gjitha objekteve me ndërtim të lartë iu lëshojmë lejen e përdorimit së bashku me Drejtorinë për Urbanizëm dhe mbrojtje të Mjedisit.	Inspektorët e ndërtimit	Drejtorinë për Planifikim Hapësinor	Mars, prill
3	Për të gjithë ata pronarë të cilët nuk kanë respektuar Ligjin për ndërtim, do të merren masa ligjore, për iniciimin e procedurave për kundërvajtje në Gjykatën Themelore për Kundërvajtje.	Inspektorët e ndërtimit	Drejtorinë për Planifikim Hapësinor	Gjatë tërë vitit
4	Ndalimi i të gjitha punimeve sipas procedurave ligjore.	Inspektorët e ndërtimit	Drejtorinë për Planifikim Hapësinor	Gjatë tërë vitit
5	Ndalimin e të gjitha punëve ndërtimore pa leje nga organi kompetent.	Inspektorët e ndërtimit	Drejtorinë për Planifikim Hapësinor	Gjatë tërë vitit
6	Në raste të fillimit të punimeve ndërtimore pa leje, do të merren të gjitha masat sipas dispozitave ligjore.	Inspektorët e ndërtimit	Drejtorinë për Planifikim Hapësinor	Gjatë tërë vitit
7	Bashkëpunimi me organet relevante, Policinë e Kosovës.	Inspektorët e Ndërtimit	Drejtorinë për Planifikim Hapësinor	Gjatë tërë vitit
8	Angazhimi në punë dhe detyrat e punës të përcaktuara me Ligjin për ndërtimin si dhe harmonizimi i punëve në bashkëpunim me drejtorin e drejtorisë.	Inspektorët e ndërtimit	Drejtorinë për Planifikim Hapësinor	Gjatë tërë vitit
9	Bashkëpunim me Drejtorinë për Kadastër, Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor, caktimi i pikave për objektet me leje ndërtimore.	Inspektorët e ndërtimit		Gjatë tërë vitit

Inspektorati i mbrojtjes së mjedisit

Nr.	PËRMBAJTJA E PUNËVE	BARTËSI I PUNËVE	BASHKËPUNON ME:	AFATI KRYRJE PUNËVE
1	Përmirësimi i shëndetit të qytetarëve dhe zvogëlimi i faktorëve të ndotjes së mjedisit jetësor.	Inspektori për mbrojtjen e mjedisit	Subjektet relevante	Gjatë tërë vitit
2	Analiza, vlerësime dhe rekomandime në lëmenjtë e industrisë dhe burimeve urbane.	Inspektori për mbrojtjen e mjedisit	Drejtorinë për Urbanizëm DMA	Gjatë tërë vitit

3	Edukimin dhe në vetëdijesimin e popullatës në lëmin e mbrojtjes së mjedisit.	Inspektori për mbrojtjen e mjedisit	Bashkëpunim me qytetarët	Gjatë tërë
4	Lumenjve “Silnica” dhe “Tërstena” t’u kthehet funksionaliteti i mëparshëm për freskim, argëtim dhe peshkim.	Inspektori për mbrojtjen e mjedisit	KRMH “Uniteti” njësia në Vushtri	Gjatë tërë
5	Gjatë muajit të higjienës të organizohen aksione me qytetarë, nxënës të shkollave fillore dhe të mesme, FSK-në, KFOR-in, si dhe me strukturat tjera për pastrimin e rrugëve kryesore dhe shesheve para ndërtesave nga mbeturinat.	Inspektori për mbrojtjen e mjedisit	Kuvendin Komunal, qytetarët, nxënësit, FSK-në, KFOR-in KRMH “Uniteti” njësia në Vushtri	Pril
6	Me këto aksione të pastrimit të vetëdijesohen qytetarët për një mjedis të pastër dhe të shëndoshë.	Inspektori për mbrojtjen e mjedisit	Departamenti për Vetëdijesim dhe Ndërgjegjësim	Pril
7	Do të angazhohemi në organizimin e fushatave për ngritjen e vetëdijes për çështjet e mbeturinave, ripërdorimin dhe riciklimin e tyre.	Inspektori për mbrojtjen e mjedisit	Kuvendin Komunal Drejtorinë për Shërbime Publike	Gjatë tërë

8	Programe për pyllëzimin e sipërfaqeve të zhveshura dhe pyllëzimin meliorativ të pyjeve të degraduara.	Inspektori për mbrojtjen e mjedisit	Autoriteti Qendror i Pylltarisë	Shkurt- mars
9	Mbrojtjen e qytetarëve nga zhurma dhe vibracionet.	Inspektori për mbrojtjen e mjedisit	Autoriteti Qendror i Pylltarisë	Mars Prill
10	Gjelbërimin e rrugëve kryesore me drunjt dekorativ.	Inspektori për mbrojtjen e mjedisit	Drejtoria për Shërbime Publike	Prill
11	Zvogëlimin e ndotjes nga transporti.	Inspektori për mbrojtjen e mjedisit	SHPK-në	Gjatë tërë vitit
12	Ripyllëzimin e sipërfaqeve djerrë me fidane të reja dhe të shtojmë sipërfaqe të gjelbëruara në qytet.	Inspektori për mbrojtjen e mjedisit		Gjatë tërë vitit
13	Mbajtja e kontakteve dhe lidhja me individë dhe asocione përkatëse, me OJQ-të vendore dhe të huaja, me organet komunale, organet e MMPH-së, e në veçanti me inspektorin sanitar, inspektorin e higjienës, drejtorin e Drejtorisë për	Inspektori për mbrojtjen e mjedisit	OJQ-të, inspektorin sanitar, inspektorin e higjienës, drejtorin e Drejtorisë për Shërbime Publike dhe me KRMH “Uniteti”, njësia në Vushtri	Gjatë tërë vitit

	Shërbime Publike dhe me KRMH “Uniteti” njësia në Vushtri etj.			
--	---	--	--	--

14	Përcjelljen e punëve të KRMH “Uniteti” njësia në Vushtri gjatë pastrimit, larjes dhe freskimit të rrugëve të qytetit, si dhe do t’i përcjellim punët gjatë mirëmbajtjes dimërore të rrugëve lokale në komunë.	Inspektori për mbrojtjen e mjedisit	Ministrinë e Mbrojtjes së Mjedisit	Gjatë tërë vitit
15	Mbikëqyrjen e zhvillimit të projekteve dhe respektimin e ndikimit në mjedis.	Inspektori për mbrojtjen e mjedisit	Drejtorinë e Shërbimeve Publike, KRMH “Uniteti”, njësia në Vushtri	Gjatë tërë vitit

Inspektorati i shërbimeve publike

Nr.	Aktiviteti	Bartësi i aktivitetit	Bashkëpunimi me:	Planifikimi
1	Inspektimi i subjekteve afariste rreth ekspozimit të mallrave që nuk lejohen.	Inspektori i shërbimeve publike	Subjektet relevante	Gjatë tërë vitit
2	Mbikëqyrja e shfrytëzimit të hapësirave publike.	Inspektori i shërbimeve publike	Drejtorinë për Shërbime Publike	Gjatë tërë vitit
3	Mbikëqyrja e hedhjeve të mbeturinave jashtë vendeve të caktuara.	Inspektori i shërbimeve publike	Qytetarët	Gjatë tërë vitit
4	Mbikëqyrja mbi kyçjet me dhe pa leje në sistemin e rrjetit të ujësjellësit dhe të kanalizimit.	Inspektori i shërbimeve publike	KRMH "Uniteti" njësia në Vushtrri	Gjatë tërë vitit
5	Mbikëqyrja e mirëmbajtjes së kanalizimit, rrugëve, shesheve, trotuareve, tregu i gjelbër, terrenet sportive dhe parqeve.	Inspektori i shërbimeve publike	Qytetarët, nxënësit	Gjatë tërë vitit
6	Mbikëqyrja e ndriçimit publik, mbishkrimet dhe reklamat.	Inspektori i shërbimeve publike	Kuvendin Komunal, Drejtorinë për Shërbime Publike	Gjatë tërë vitit
7	Mbikëqyrja e panove dhe reklamave të të gjitha llojeve.	Inspektori i shërbimeve publike	Kuvendin Komunal, Drejtorinë për Shërbime Publike	Gjatë tërë vitit
8	Mbikëqyrja e të gjitha rrethojave përballë sipërfaqeve publike.	Inspektori i shërbimeve publike	Të gjithë resorët e inspektorëve dhe Policinë e Kosovës	Gjatë tërë vitit

9	Mbikëqyrja e zbrazjeve të materialit me ose pa leje (rëra, dheu, materiali ndërtimor që pengojnë në qarkullim të lirë të udhëtarëve).	Inspektori i shërbimeve publike	Drejtorinë për Shërbime Publike, Policinë e Kosovës	Gjatë tërë vitit
10	Bashkëpunim i mirëfilltë me të gjithë inspektorët tjerë, si në inspektime po ashtu edhe në aksione të përbashkëta, si dhe me Policinë e Kosovës.	Inspektori i shërbimeve publike		Gjatë tërë vitit
11	Inicim të procedurës për kundërvajtje për të gjithë personat fizikë dhe juridikë që bien ndesh me ligjet dhe rregulloret komunale.	Inspektori i shërbimeve publike		Gjatë tërë vitit
12	Angazhimi i kryerjes së detyrës me përpikëri, si dhe punët dhe detyrat që merren nga drejtori i Drejtorisë për Inspektime.	Inspektori i shërbimeve publike		Gjatë tërë vitit

Inspektorati i komunikacionit

Nr.	Aktiviteti	Bartësi i aktivitetit	Bashkëpunimi me:	Peri koh
1	Mbikëqyrja dhe inspektimi i të gjithë operatorëve që merren me veprimtarinë mbi transportin e udhëtarëve dhe mallrave.	Inspektori i komunikacionit	Subjektet relevante Policinë e Kosovës, gjykatën, inspektoratet qendrore dhe komunale	Gjatë vitit
2	Inspektimi i autotaxi-ve.	Inspektori i komunikacionit	Drejtorinë për Shërbime publike	Gjatë vitit
3	Operatorët "taxi".	Inspektori i komunikacionit	Drejtorinë për Shërbime publike	Gjatë vitit
4	Inspektimin e automjeteve të transportit të mallrave.	Inspektori i komunikacionit	Qytetarë	Gjatë vitit
5	Ndërmarrjet të cilat merren me transport të udhëtarëve (autobusët, kombibusët).	Inspektori i komunikacionit	Inspektoratet e resorëve tjerë	Gjatë vitit
6.	Kontrollimin e vijave komunale urbane dhe ndërrurbane.	Inspektori i komunikacionit	Drejtorinë për Shërbime publike	Gjatë vitit
7	Angazhimi i kryerjes së detyrës me përpikëri, si dhe punët dhe detyrat që merren nga drejtori.	Inspektori i komunikacionit		Gjatë vitit

Inspektorati i higjienës

Nr	Aktiviteti	Bartësi	Bashkëpunimi me:	af
1	Angazhime të rregullta në mbikëqyrjen e mbajtjes së pastërtisë të vitrinave të lokaleve.	Inspektorja e higjienës komunale	Drejtorinë për Inspektime dhe KRMH “Uniteti”	Përgj. tërë v.
2	Mbikëqyrje e rrjedhjes së ujit, kanalizimit, pusetave, si dhe gropave septike kudo që ndodhen ato në territorin e komunës tonë.	Inspektorja e higjienës Komunale	Drejtorinë për Inspektime dhe KRMH “Uniteti”	Përgj. tërë vi
3	Angazhime të rregullta për mbikëqyrjen e mbajtjes së pastërtisë të ndërtesave.	Inspektorja e higjienës komunale	Drejtorinë për Inspektime dhe banorët e ndërtesave	Përgj. tërë vi
4	Mbikëqyrje e mbajtjes së pastërtisë dhe pamjes së jashtme të ndërtesave.	Inspektorja e higjienës komunale	Drejtorinë për Inspektime dhe banorët e ndërtesave	Përgj. tërë vi
5	Do të kemi angazhime për mbikëqyrjen e pastërtisë së qytetit me rrethinë dhe objektet komunale, me qëllim të ngritjes së cilësisë të higjienës në komunën tonë.	Inspektorja e higjienës komunale	Drejtorinë për Inspektime dhe pronarët e lokaleve afariste	Përgj. tërë vi
6	Inspektime të kohëpaskohshme për mbajtjen e pastërtisë së tregut.	Inspektorja e higjienës komunale	Drejtorinë për Inspektime dhe pronarit të tregut	Përgjat. tërë vit
7	Mbikëqyrje të pastërtisë të sipërfaqet publike në vendbanime.	Inspektorja e higjienës komunale	Drejtorinë për Inspektime dhe banorët e komunës	Përgjat. tërë vit
8	Mbikëqyrjen e pastërtisë së sipërfaqeve të gjelbëruara publike, terreneve sportive.	Inspektorja e higjienës komunale	Drejtorinë për Inspektime dhe KRMH “Uniteti”	Përgjat. sezonës pranver –vjesht
9	Shqyrtimi i të gjitha kërkesave të qytetarëve sa i përket lëmisë së higjienës komunale.	Inspektorja e higjienës komunale	IHK	Përgjat. tërë viti

10	Të kryejë punët dhe detyrat e punës sipas urdhrit të mbikqyrësit në pajtim me ligjin.	Inspektorja e higjienës komunale		Përgjës tërë vi
11	Ndërmarrjen e masave administrative me qëllim të respektimit të rregulloreve komunale, si dhe dispozitat tjera ligjore në fuqi që e rregullojnë këtë lëmi.	Inspektorja e higjienës komunale	Drejtorinë për Inspektime	Përgjës tërë vi
12	Mbikëqyrjen e pastrimit të borës të rrugëve dhe trotuareve përgjatë sezonit dimëror.	Inspektorja e higjienës komunale	OE, fitues për mikëqyrjen e pastrimit të borës të rrugëve dhe trotuareve përgjatë sezonit dimëror	sipas rasteve

Administrata

Objektiv i përgjithshëm strategjik:						
Shërbime administrative kualitative, të qasshme, të bazuara në procedura administrative të arsyeshme dhe duke përdorur metodat e e-qeverisjes të orientuara kah nevojat e qytetarëve dhe bizneseve.						
Aktivitetet	Afati i zbatimit	Përgjegjës	Mbështetës	Kostoja totale	Burimi i financimit	Produkti
1. Azhurimi i informacioneve lidhur me shërbimet administrative që ofrohen nga Komuna.	Mars 2019	Drejtoritë/Zyrat Q.SH.Q.K	Kryetari i komunës			Shërbimi i azhuruar me kërkesat dhe nevojat aktuale.
2. Funksionalizimi i arkivit të administratës së Komunës	Qershor 2019	Drejtoritë	Kryetari i komunës			Arkivi funksional dhe profesional

3. Implementimi i koncept dokumentit për ofrimin e shërbimeve më të mirë dhe sa më pranë qytetarëve dhe bizneseve.	Prill 2019	Q.SH.Q.K dhe drejtoritë komunale	Zyra e kryetarit Drejtoritë			Funksionimi në bazë të koncept-dokumentit
4. Hartimi i fletushkave, informacioneve dhe broshurave lidhur me shërbimet e Komunës.	Mars 2019	Q.SH.Q.K	Kryetari i komunës			Informim i shpejt dhe i sakt, transparencë më e lartë.
5. Trajnimi i Nëpunësve Civil.	prill 2019	Zyra e personelit në bashkëpunim me IKAP dhe Drejtoritë				150 punonjës civil te trajnuar

Planet e punëve sipas sektorëve të drejtorisë:

Zyra e gjendjes civile

Objektivat	Aktiviteti(Detyrat)	Afatet	Bartësit	Verejtje
1. Përditësimi dhe administrimi i regjistrave themeltar në formën fizike dhe elektronike, i Regjistrin qendror të gjendjes civile dhe i regjistrave të veçantë(Special) të GJC.	1.1.Verifikimi i qytetareve në regjistrin themeltarë elektronik dhe unifikimi i të dhënave dhe shënimeve me regjistrin themeltar fizik. 1.2. Mirëmbajtja dhe kujdesi i regjistrave themeltar fizik dhe elektronik dhe të dokumenteve të arkivuara. 1.3. Përditësimi i shënimeve dhe regjistrimi i shtetasve në regjistrin themeltar dhe qendror, 1.4. Përditësimi dhe regjistrimi i qytetarëve sipas nenit 31 dhe 32 të ligjit për gjendjen civile. 1.5. Përditësimi dhe regjistrimi në regjistrin themeltar dhe qendror të vendbanimit dhe vendqëndrimit, 1.6. Ri regjistrimi(Rikonstruksioni) i qytetarëve që dëshmojnë që kanë qenë të regjistruar më parë në regjistrin themeltarë. 1.7. Regjistrimi i shtetasve të huaj në regjistrin qendror, 1.8. Regjistrimi i personave të natyralizuar sipas vendimit të MPB-së,	Sipas afateve ligjore	Zyrtarët e GJC	

2. Përdorimi dhe respektimi i akteve ligjore dhe nënligjore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.	2.1. Përdorimi dhe zbatimi i ligjeve që kanë të bëjnë me gjendjen civile, 2.2. Përdorimi dhe zbatimi i udhëzimeve administrative që rregullojnë gjendjen civile, 2.3. Zbatimi i udhëzuesve dhe manualeve që kanë të bëjnë me procedurat e regjistrimeve dhe lëshimit të certifikatave të gjendjes civile, 2.3. Përdorimi dhe zbatimi i rregulloreve dhe manualeve që kanë të bëjnë me aplikacionin e gjendjes civile,	Sipas afateve ligjore	Zyrtarët e GJC	
3. Regjistrimi i saktë dhe i drejtë i fakteve të gjendjes civile (lindje, martesë dhe vdekje), shtypja, ruajtja dhe arkivimi i akteve dhe dokumenteve të tjera që ndërlidhen me shërbimin e gjendjes civile.	3.1. Regjistrimi i fakteve të gjendjes civile (lindje, martesë, vdekje etj.) 3.2. Regjistrimet e mëvonshme në bazë të vendimeve, 3.3. Regjistrimet e veçanta (speciale), 3.4. Kompletimi dhe ruajtja e dosjeve që kanë të bëjnë me regjistrimet e fakteve të gjendjes civile, 3.5. Shtypja dhe arkivimi i akteve të lindjeve, martesave dhe vdekjeve, 3.6. Gjenerimi i numrit personal, 3.7. Regjistrimi i fëmijëve të adoptuar në bazë të vendimit të gjykatës, 3.8. Regjistrimi i personave të natyralizuar në bazë të vendimeve të MPB-së. 3.9. Nxjerrja e vendimeve për korrigjime, ndërrime dhe regjistrime me vonesë.	Sipas afateve ligjore	Zyrtarët e GJC	
4. Zbatimi i vendimeve për ndërrimin, korrigjimin e të dhënave personale në mënyrë sa më efektive dhe elektronike dhe në librat fizik si dhe ruajtja dhe arkivimi i këtyre dokumenteve në regjistrator.	4.1. Zbatimi i vendimeve për ndryshimin dhe korrigjimin e të dhënave personale dhe shënimeve të mëvonshme në librin fizik. 4.2. Përcjellja e vendimeve për ndryshime dhe korrigjime të të dhënave personale në regjistrin themeltar dhe qendror. 4.3. Zbatimi i Aktgjykimeve të gjykatës për shkurorëzim, 4.4. Zbatimi i vendimeve për regjistrim, ndërrim, korrigjim, 4.5. Zbatimi i raportit policor për dokumentet e humbura, 4.6. Zbatimi i deklaratës për kthimin e mbiemrit, 4.7. Zbatimi i deklaratës së Atësisë-Amësisë 4.8. Zbatimi i vendimit të gjykatës mbi themelimin e adoptimit	Sipas afateve ligjore	Zyrtarët e GJC	

5. Lëshimi i saktë dhe i shpejtë certifikatave dhe dokumenteve të Gjendjes Civile.	5.1. Lëshimi i dokumenteve personale	Sipas afateve ligjore	Zyrtarët e GJC	
6. Informimi i palës në mënyrë të saktë të shpejtë dhe ofrimi i shërbimeve më cilësore, efektive dhe efikase për qytetarët;	6.4. Ofrimi i shërbimeve cilësore për qytetarët,	Sipas afateve ligjore	Zyrtarët e GJC	
7. Ruajtja e fshehtësisë së të dhënave personale dhe komunikimi i tyre vetëm personave që i parasheh ligji.	7.1. Të dhënat personale i komunikohen vetëm personit për të cilën mbahen shënimet. 7.2. Certifikatat dhe dokumentet i jepen vetëm personit që i përkasin, 7.3. Ruajtja e regjistrave dhe dosjeve me të DHP në orman metalik ku siguria e tyre është e garantuar.		Zyrtarët e GJC	

Sektori për Punë të Përbashkëta dhe Teknologji Informative

Objektivat	Aktiviteti(Detyrat)	Afatet	Bartësit	Vërejtje
1. Funksionaliteti i tërë sistemit të teknologjisë informative të administratës së komunës	1.1 Implementimi i të gjitha politikave dhe procedurave të TI; 1.2 Kujdesi për zbatimin e politikës së sigurisë së rrjetit, shfrytëzimit të resurseve të TI;	Gjatë tërë vitit	Udhëheqë si i sektorit	
2. Administrimi, monitorimi dhe mirëmbajtja e teknologjisë për të siguruar qasje maksimale	2.1 Administrimi i serverëve dhe pajisjeve tjera qendrore të sistemit të TI në Komunë; 2.2. Mirëmbajtja, instalimi, konfigurimi, testimi dhe zgjerimi i rrjetit; 2.3 Formatizime, instalime të aplikacioneve apo softuerëve të ndryshme si dhe zgjidhja e probleme të ndryshme softuerike; 2.4 Administrimi dhe mirëmbajtja e ueb faqes zyrtare, aplikacioneve dhe bazave të të dhënave të komunës; 2.5 Evitimi i defekteve dhe rekomandimi për servisim të pajisjeve të TI;	Gjatë tërë vitit	Udhëheqë si i sektorit; Zyrtari i TI	

4. Mbështetje lidhur me përdorim dhe shfrytëzim të resurseve të TI	4.1 Trajnon dhe aftëson stafin për përdorim të teknologjisë ekzistuese dhe teknologjive të reja; 4.2 Ofrimi i qasjes për gjithë personalin në sistemin e TI dhe resurset e saja;	Gjatë tërë vitit		
5. Menaxhimi dhe administrimi i punëve të përbashkëta	5.1 Identifikimi i nevojave për furnizim me pajisje, inventar dhe mirëmbajtjen e tyre; 5.2 Mbikëqyrja e punës lidhur me lekturim dhe përkthim; 5.3 Mbikëqyrja e mirëmbajtjes së objektit të komunës	Gjatë tërë vitit	Udhëheqësi Sektorit	
6. Ofrimi i shërbimeve të përkthimit	6.1 Përkthim në mbledhjet e organizuara nga kryetari dhe mbledhje, takime, etj 6.2 Përkthimi i të gjitha dokumenteve sipas kërkesave të zyrtarëve të administratës komunale.	Gjatë tërë vitit	Përkthyesi	
7. Ofrimi i shërbimeve të lekturës	7.1 Lekturimi i dokumenteve të kuvendit, kryetarit dhe dokumenteve të shërbimeve tjera sipas kërkesave të zyrtarëve të administratës komunale; 7.2 Asistim në përpilimin e terminologjisë së unifikuar ligjore dhe arsimore 7.3 Mbështetje stafit lidhur me shkresat në përmbytjen e tyre në aspektin e strukturës sintaksore (gjuhësore)	Gjatë tërë vitit	Lektori	
8. Mirëmbajtja e të gjitha stabilimenteve elektrike dhe teknike në lokalet e ndërtesës së komunës si dhe mirëmbajtja e rrjetit të ujësjellësit në objektin e komunës, pastërtisë dhe nyjave sanitare.	9.1 Ndërrimi dhe riparimi i stabilimenteve, montimin e pjesëve të reja sipas nevojës së parashtruar; 9.2 Mirëmbajtja e inventarit nëpër zyrë; 9.3 Kujdesi për funksionalitetin e gjeneratorit; 2.2 Kujdesi për furnizimin me mjete higjienike për nevoja të objektit të komunës	Gjatë tërë vitit	Mirëmbajtësi	

Qendra për Shërbim për Qytetar

Qëllimi kryesor(Objektivat)	Aktiviteti(Detyrat)	Afatet	Bartësit	Vërejtj
1.Pranimi i të gjitha kërkesave/ankesave të parashtruara nga qytetarët/bizneset dhe grupet e interesit.	1-1.Pranimi dhe regjistrimi i kërkesave/parashtresave 1.2 Pranimi dhe skanimi i kërkesave/parashtresave 1.3 Këshillimi dhe ndihma juridike-administrative për mënyrën e plotësimit të kërkesave dhe parashtresave 1.4 Mbajtja e dosjeve, statistikave të parashtresave dhe kërkesave te paraqitura nga qytetaret 1.5 Përcjellja në mënyrë elektronike e lendeve tek drejtorit përkatëse dhe marrja e përgjegjës	Gjatë gjithë vitit	Zyrtarët e QSHQ-së	

Zyra për të drejtat e njeriut

Nr.	Qëllimi I përgjithshëm	Aktiviteti	Stafi përgjegjës	Afati	Buxheti
1.	Avancimi i pozitës shoqërore se femrës në vendimmarrje.	- Organizimin e Zyrës për Barazi Gjinore në mënyrë funksionale, qasje në problemet kyqe të femrave, trajnime promovuese dhe aktivitete tjera me undë njejtin destinim.	Zyrtarja për Barazi Gjinore	Punë kontinuele gjatë vitit vijues	
2.	Shënimi i Ditës Ndërkombëtare te gruas, 8 Marsit	- Organizimi e një Tryeze të hapur me temë: Pozita e femrës në komunën und. Kryefamiljare. Punimet	Zyrtarja për Barazi Gjinore.	Java e pare e marsit 8- Marsi. Tryeze	1000€
3.	Përgatitja e një data baze, statistikore për buxhetimin gjinore në Komunën e Vushtrrisë duke përfshirë punësimin mbrojtjen shëndetësore , pjesëmarrjen në politikë dhe pozita vendimmarrëse	- Vizita nëpër të gjitha institucionet publike dhe private më qëllim te verifikimit a janë të mbrojtura të dy Gjinit barabarte sipas ligjit, a kanë kontrata a marrin rrogë njësoj, për punën e njëjte të përformuar. Sa	Zyrtarja për Barazi Gjinore, zyra e personelit ,Punëdhënësit Qendra për punësim dhe aftësim	Janar-Dhjetor	,

		respektohet pushimi i lehonisë i garantuar me ligjin në fuqi			
4	Vetëdijesimi në zonat rurale për të drejtat trashëgimore	- Hulumtim i shkaqeve të braktisjes së shkollës nga nxënësit në komunën e Vushtrisë, verifikimi i rasteve të nxënësve shkollimi i të cilëve varet nga pagesa e një bilete autobusi - Inicim i Seancave pa pagese me Psikologun për nxënës që e braktisin shkollën, ose që kanë potencial për ta braktisur - Vizita në shkolla të komunës Ligjërata dhe aktivitete të ndryshme	Zyrtarja për Barazi Gjinore , Drejtoria e Arsimit , Drejtoret e shkollave Drejtoria për Mirëqenie Sociale Enti për Pune Psikologu i Shkollës NJKDNJ a është kompetence e ZBGJ me duket se jo	Ka filluar procesi, është në vazhdimësi	
5.	Shënimi i 1 Qershorit Dita Ndërkombëtare e Fëmijëve.	Shpallja e tregimit më të mirë për të drejtat e fëmijëve në shkolla fillore	ZDF dhe Asambleja e fëmijëve të komunës.	Qershor Eskrukrzion me fëmijë të hendikepuar duke siguruar me buxhet të ZBGJ	500,00€
6.	Inkurajimi i femrave në punësim dhe femrave që do të duhej të promovohen dhe personave me nevoja të veçanta.	- Përgatitja e raporteve statistikore të pjesëmarrjes së femrave, gjithashtu edhe raporti mbi kualifikimin e tyre. - Organizimi i debateve, seminare trajnime. - Avokimi për njohjen dhe rishpërndarjen e punës së papaguar të grave; - Mbështetja e ndërmarrësisë së grave nëpërmjet trajnimit të	Zyrtarja për Barazi Gjinore Komuna Enti për punësim Qendra për punë sociale	Punë permanente për gjatë gjithë vitit.	

		aftësive dhe teknikave të prodhimit.			
7.	Shënimi i 16 Tetori dita e personave me nevoja te veçanta dhe mundësive të barabarta dhe ofrimi i mundësive profesionale.	- Huluntim i shkaqeve të braktisjes së shkollës nga nxënësit në komunën e Vushtrri, verifikimi i rasteve të nxënësve shkollimi i të cilëve varet nga pagesa e një bilete autobusi - Inicim i Seancave pa pagese me Psikologun për nxënës që e braktisin shkollën, ose që kanë potencial për ta braktisur	NJKDNJ Haandikos Zyrtarja për Barazi Gjinore , Drejtoria e Arsimit , Drejtoret e shkollave Drejtoria për Mirëqenie Sociale Enti për Punë Psikologu i Shkollës	Permanent	200,00
8	Shënimi i 25- Nëntorit, Dita ndërkombëtare kundër dhunës në familje 25 Nëntori	- Organizimi i aktiviteteve gjatë 16 ditëve të aktivizimit kundër dhunës në familje - Fushatë vetëdijes ese kundër dhunës, më qëllim të uljes së rasteve të dhunës, tryeza të hapura me dy gjinitë.	Zyrtarja për Barazi Gjinore Zyra e kryetarit ZÇGJ. Policia, Qendra për Punë Sociale.	25 Nëntor -10 Dhjetor	2.000,00
9.	Fuqizimi i Bashkëpunimit mes Zyrtares për Barazi Gjinore dhe OJQ-ve përmes aktiviteteve të përbashkëta	- Organizimi i 4 takimeve gjatë vitit me temë „Përkrahja dhe bashkëpunimi i OJQ-ve të komunitetit të grave në 4 tema specifike“ aspektet dhe bashkëpunimi i me ngushtë me OJQ.	Zyrtarja për Çështje Gjinore. OJQ-ve	Punë Kcontinue gjatë vitit 2017/18	2.400,00
10	Organizimi fushatave vetëdijes ese kundër trafikimit më qenie njerëzore	- 4 fushatave vetëdijesimi për parandalimin e trafikut më qenie njerëzore - Identifikimi i numrit të personave të trafikuar - Identifikimi Nevojave të tyre primare	Policia e Kosovës Zyrtarja për Barazi gjinore , QPS Gjykata Terres de Home	Maj – Nëntor <i>Ne bashkëpunim me OJQ dhe KVL</i>	2.000,00

		- Adresimi i këtyre kërkesave Institucioneve përgjegjëse			
11.	Promovimi i kontakteve nacionale dhe ndëretnike ne bashkëpunim me aktivitete e grave.	Kërkimi i mundësive për shkëmbimin e vizitave dh trajnimeve në zhvillimin e femrës me etnitete e tjera dhe ato jashtë vendit apo ndërkombëtare.	MALP NJKDNJ		400€
12.	Inkurajimi i femrave vetushqyese në punësim dhe femrave që do te duhej të promovohen dhe personave me aftësi te kufizuar	- Përgatitua e raporteve statistikore te pjesëmarrjes se femrave gjithashtu edhe raporti mbi kualifikimin e tyre. - Të organizohen debate te ndryshme për këtë çështje dhe te organizohen seminare trajnime.	Komuna NJKDNJ	Punë Kontinuele	
13.	Shënimi i 1 Dhjetorit, Dita kundër SIDËS	- Organizimi i debateve takime, hulumtime dhe ligjërata nëpër shkolla	NJKDNJ	Dhjetor 2018	e
14.	Shënimi i 10- Dhjetor Dita e të drejtave të njeriut	- Organizimi i debateve aktivitete sportive	NJKDNJ	Dhjetor 2010 Me KVL R	400€ ushqim tradional

Gjeodezi, kadastër dhe pronë

Aktivitetet që kanë për qëllim realizimin e prioriteteve të drejtorisë

1	Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër	Objektivat Shpronësimi i pronave për realizimin e projekteve.	Aktivitetet Zhvillimi i procedurave të shpronësimit	Afati Permanen	Ndikimi financiar 160000 euro (80000 euro nga të hyrat vetanake dhe 30000 euro nga grantet, 50000 të bartura nga viti paraprak)	Pjesëmarrësit tjerë Ministria e Financave	Ndërlidhja me realizimin e projekteve me interes për komunën dhe qytetarët
2	prioritet nr. 2 Uzurpimet						
		Objektivat, mbrojtja e pronës komunale.	Zhvillimi i procedurave për lirim të pronës komunale të uzurpuar		Permanen	zero	Drejtoria e Inspektimeve
3		Zbatimi i aktvendimeve lidhur me ndarjen e pronës nga komasacioni, të lëshuar nga komisioni për komasacion	Futja e të dhënave në RDPP për zonat kadastrale në komasacion të përfunduara		Permanen	zero	Agjencioni Kadastral i Kosovës
4		Raportimi para Kuvendit të Komunës lidhur me pronat komunale.	Informatë lidhur me pronat komunale		Shtator	Ndikimi financiar zero	
5		Lista e pronave të paluajtshme të komunës.	Përpilimi i listës së pronave komunale		Afati permanent	zero euro	Drejtoria për Bujqësi
5		Objektivat, nëritja e efikasitetit në punë	Përgjigjja në kohë ndaj kërkesave të paraqitura nga palët		Afati permanent	Ndikimi financiar në euro zero	

Mbrojtje dhe shpëtim

Nr.	Emërtimi i detyrave-aktiviteteve të planifikuara	Baza e planifikimit	Bartësit e aktiviteteve	Bashkëpunimi me:	Afati	
					Prej	Deri
1	Hartimi dhe azhurnimi i planeve: Vlerësimi i rrezikut nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera, Plani për reagim emergjent.	Udhëzimi administrativ për metodologjinë e hartimit të vlerësimit të rrezikut	DMSH	Kryqin e Kuq, Policinë e Kosovës, NJPZSH, si dhe të gjitha bizneset që inkorporohen në këtë vlerësim	Gjatë vitit	Gjatë vitit
2	Hartimi i raporteve periodike.	Raport për Kryetarin	DMSH	NJPZSH	Çdo 6 muaj	Gjatë vitit
3	Bashkëpunimi dhe koordinimi me ekspertë për interes të emergjencave civile.	Plani i punës	DMSH,	Drejtoritë komunale NJPZSH, OJQ, PK, Kryqin e Kuq	Gjatë vitit	Gjatë vitit
4	Angazhimi për pastrimin dhe hapjen e kanaleve nga vërshimet e ujit, pastrimin e rrugëve nga bora dhe largimin e pengesave eventuale gjatë situatave emergjente.	Plani i punës	DMSH	Drejtoritë komunale	Gjatë vitit	Gjatë vitit
5	Formimi dhe aftësimi i ekipeve vullnetare për MSH.	Plani i punës	DMSH	OJQ - shoqëria civile, NJPZSH	Gjatë vitit	Gjatë vitit
6	Azhurnimi i listave të zjarrfikësve fillestarë në njësitin e vullnetarëve, si dhe pajisja e tyre me mjete materialo-teknike.	Plani i punës, Ligji për mbrojtje nga zjarri	DMSH	NJPZSH, kryetarët e bashkësive lokale	Prill	Shtator

7	Organizimi i seminarit me subjektet në terren me temën: “Rëndësia e planifikimit efektiv në përballimin situatave emergjente”.	Plani i punës	DMSH,	Të gjitha subjektet që kanë obligim ligjor NJPZSH	Qershor	Shtator
8	Sensibilizimi i popullatës për mbrojtjen nga të gjitha fatkeqësitë (natyrore, teknike etj).	Plani i punës	DMSH	Të gjitha bizneset komunale, NJPZSH kryetarët e bashkësive lokale	Mars	Nëntor
9	Planifikimi për mbajtjen e ushtrimit fushor 24 orësh (Varësisht prej mundësive financiare).	Plani i punës	DMSH	FSK-në, Policinë e Kosovës, Kryqin e Kuq, drejtoritë komunale, shërbimin medicinal KEDS-in, ujësjellësin regjional NJZ, etj	Prill	Korrik
10	Koordinimi i punëve rreth dhënies së lejeve për ndërtim, respektimi i standardeve për raste emergjente.	Plani i punës, Rregullorja mbi ndërtim, Ligji i mbrojtjes nga zjarri	DMSH	Drejtorinë për Urbanizëm, inspektionin për ndërtim	Gjatë gjithë vitit	Gjatë gjithë vitit
11	Evidentimi, koordinimi dhe propozimi i punëve, si dhe aktivitetëve, për eliminimin e pikave emergjente, të cilat paraqesin rrezik në territorin e komunës.	Plani i punës - gatishmërisë emergjente	DMSH	Bordin e drejtorëve, Drejtorinë për Inspektive, Drejtorinë për Urbanizëm, Gjeodezi, Kadastër, dhe Ekonomi	Gjatë vitit	Gjatë vitit
12	Koordinimi i punëve dhe aktivitetëve, si dhe menaxhimi i strehimoreve.	Plani i punës	DMSH	Drejtorinë e Urbanizmit	Gjatë vitit	Gjatë vitit
13	Kontaktet permanente në relacionin DMSH me	Plani i punës	DMSH	QOER-Mitrovicë, si dhe AME Prishtinë	Gjatë vitit	Gjatë vitit

	Qendrën regjionale për koordinim emergjent.					
14	Bëhet planifikimi, evidentimi, sistemimi i resurseve njerëzore dhe mjeteve materialo-teknike, për nevoja emergjente.	Plani i punës	DMSH	NJPZSH, zyrën e Kryqit të Kuq	Gjatë vitit	Gjatë vitit
15	Zyra e alarmit dhe koordinimit emergjent, (ZAKE) informimi i publikut për rreziqet e mundshme dhe dhënien e udhëzimeve për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë.	Plani i punës, Ligji për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera	DMSH	Qendrat e BL ku janë të vendosur radiolidhjet	Gjatë tërë vitit	Gjatë tërë vitit
16	Organizimi-funksionimi i ndërlidhjeve për nevoja të mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës, në përputhje me sistemin unik të ndërlidhjeve.	Plani i punës, Ligji për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera	DMSH	Institucionet ku janë të vendosura radiolidhjet	Gjatë tërë vitit	Gjatë tërë vitit
17	Evidentimi i prishjeve dhe kujdesi për mirëmbajtje i mjeteve për ndërlidhje në subjekte emergjente dhe shkolla.	Plani i punës	DMSH	Subjektet emergjente dhe shkollat	Gjatë tërë vitit	Gjatë tërë vitit
18	Azhurnimi i planeve të ZAKE-së.	Plani i punës	DMSH	Subjektet emergjente, Policia e Kosovës, emergjenca medikale, NJPZSH	Gjatë vitit	Gjatë vitit
19	Renovimi dhe sigurimi i licencave për radiorrjetën	Plani i punës	DMSH	ARKEP	Korrik	Gusht

Kulturë Rini dhe Sport

Nr	Objektivat	Aktivitetet	Periudha e planifikuar për realizim	Bartësit e aktiviteteve
1.	Pasurimi i bibliotekës së qytetit	- Organizimi i kampanjës “Ne dhurojmë libra”	Janar – mars 2019	DKRS
2.	Përkrahja e autorëve të rinj	- Organizimi i promovimeve të ndryshme të librave, qoftë të krijuesve shkencorë, qoftë të atyre të rinj	Janar – dhjetor 2019	• DKRS • Klubet letrare në Vushtrri
3.	Zbulimi i talentëve të rrallë në fushën e publikimeve	- Zbulimi i librit të rrallë në nivel komune, veçanërisht nëpër shkolla të komunës	Janar – mars 2019	• DKRS • DKA
4.	Inventarizimi i muzeut (Monumenti-“Shtëpia e Mahmut agë Gjinollit”)	- Dizajnimi i inventarit - vitrinave sipas planit të kurimit të muzeut	Janar-shkurt 2019	• DKRS
5.	Krijimi i sektorit të “Luftës së fundit 1998-1999”	- Krijimi i sesionit të veçantë të Luftës së fundit 1998-1999, ku në bashkëpunim me familjarët e dëshmorëve, martirëve dhe shoqatat e dala nga lufta do të përkushtohemi të hulumtojmë dhe të mbledhim çdo gjë të trashëguar nga dëshmorët, martirët e luftës, etj., me qëllim që luftën e sakrificën e tyre hyjnore për liri e	Janar-qershor 2019	• DKRS

		pavarësi ta ngrisim edhe në një institucion siç është muzeu		
6.	Rivitalizimi i Monumentit – “Shtëpia e Mahmut agë Gjinollit” në muze	- Bartja e pasurisë së muzeut në shtëpinë e përhershme (Monumenti – “Shtëpia e Mahmut agë Gjinollit”)	Janar-mars 2019	• DKRS
7.	Krijimi i etno-parkut	- Organizimi i një etno-parku të hapur në oborrin e muzeut (Monumenti “Shtëpia e Mahmut agë Gjinollit”), ku do të ekspozohen objekte të ndryshme kulturore nga arkeologjia dhe etnologjia	Janar – dhjetor 2019	• DKRS
8.	Organizimi i tribunave	- Organizimi i disa tribunave me qytetarët e Vushtrisë, me tema të ndryshme që kanë të bëjnë me etnokulturën shqiptare, trashëgiminë e luajtshme dhe të paluajtshme etj., në ç’rast do të ftohen shumë vendas të grupmoshave të ndryshme dhe intelektualë, të cilët kanë kontribuar në hulumtimin e vlerave kulturo-historike	Maj – tetor 2019	• DKRS
9.	Pranimi dhe ruajtja e materialit arkivor	- Pranim – dorëzimi i lëndëve arkivore të Gjykatës komunale (vitet 1985-1988), - pranim –dorëzimi i materialit të komunës	Janar – dhjetor 2019	DKRS Gjykata komunale, Komisioni arkiv-gjykatë
10.	do të synojmë që të bëjmë digjitalizimin e bibliotekës	- Krijimi i programit digjital	Mars-nëntor 2019	• DKRS

11.	Përkujtimi i “Epopesë së UÇK-së”	- Homazhe, - program artistik	5,6 dhe 7 mars 2019	DKRS, shoqatat e dala nga lufta, shkollat e mesme të ulëta dhe të larta
12.	Shënimi i “Ditës së Gruas” – 8 Marsit	- Program artistik, - orë letrare me poetet femra, - ndeshje hendbolli, volejboli në konkurrencën e femrave, - “Dita e gruas”	8 mars 2019	DKRS • Klubet sportive të femrave
13.	Shfaqja teatrale	- Shfaqja premierë dhe reprizimi- i saj disa herë, - shfaqje komediale, premierë për të rritur	Prill – dhjetor 2019	• DKRS
14.	Shënimi i “Ditës ndërkombëtare të çlirimit të të burgosurve”	-Tryezë e rrumbullakët me historianë dhe të përvuajtur nëpër burgje	11 prill 2019	DKRS, Historianët, shoqata e të burgosurve politik, organizatat joqeveritare
15.	Shënimi i “Ditës ndërkombëtare të librit”	- Kampanjë vetëdijesuese nëpër shkolla, - Organizimi i një tryeze për rëndësinë e librit	23 prill 2019	DKRS, organizatat rinore, shkollat fillore dhe të mesme
16.	Organizimi i manifestimit “Zëri më i mirë” - Vushtrria 2019	- Selektimi i të rinjve me aftësi këndimi, - Ushtrimi me të përzgjedhurit, - Organizimi i finales dhe shpallja e fituesve	25 prill - 9 maj 2019	• DKRS

17.	Përkujtimi i masakrës së Studimes “Studimja 99”	- Homazhe, - Akademi përkujtimore në Studime, - Turne, memorial në shah “Studimja 99”, - Masakra e Studimes (2 Maji 1999)	2 maj 2019	Institucionet komunale, shoqatat e dala nga lufta e UÇK-së
18.	Përkujtimi i masakrës së Vushtrisë “22 Maji”	- Homazhe, - Akademi përkujtimore, - Masakra e 22 Majit (1999)	22 maj 2019	Komuna, shoqatat e dala nga lufta
19.	Përkujtimi i masakrës së familjes Gërxhaliu	- Homazhe - 31 Maj, masakra ndaj familjes së Selatin Gërxhaliut	31 maj 2019	• DKRS, shoqatat e dala nga lufta e UÇK-së
20.	Shfaqja e dramës, Premierë	Do të ketë karakter edukativ, arsimor, social etj.	Qershor-dhjetor	• DKRS
21.	Shënimi i “Ditës ndërkombëtare të fëmijëve” (1 qershor)	- Festivali për fëmijë, - Turne në basketboll, grupmoshat e reja, - Gara pikturë me fëmijë në shesh, - Karnavali me personazhet e filmave vizatimorë	1 qershor 2019	DKRS, Shkolla e muzikës “Tefta Tashko”, klubet sportive, shkollat fillore
22.	Shënimi i “Ditës së çlirimit të Vushtrisë” (17 qershor)	- Homazhe, - Program kulturo-artistik, - Hapja e ekspozitës, - Orë letrare, - Gara sportive shkollore	17 qershor 2019	Shoqatat e dala nga lufta, organizatat rinore SHPKF SSH

23.	Manifestimi "Takimet e Poeteshave Shqiptare"	-Përzgjedhja e poezive -Pritja e poeteshave -Ora e madhe letrare -Shpallja e fitueseve	Qershor ose shtator 2019	Komuna e • DKRS • Poetet • Juria
24.	Organizimi i panaireve artizanal	-Organizimi i panairit artizanal-etno-kulturor në nivel regjional gjatë muajit të diasporës, ku do të ekspozohen artizanate nga mjeshtërit apo artizanatët.	Korrik- gusht 2019	• DKRS • Artizanët
25.	Shënimi i Ditëve të Diasporës	-Program Kulturo-artistik -Orë letrare -	Korrik 2019	DKRS Organizatrat rinore Klubet sportive
26.	Shënim i "Ditës së Dëshmorëve të Kombit" për Komunën e Vushtrrisë	- Homazhe - Akademi përkujtimore - Hapja e ekspozitës me fotografi - Turneu Tradicional ne Hendboll "Jeton Tërstena-TOTA"	1 shtator 2019	• DKRS • Shoqatat e dala nga lufta
27.	Shënimi i "Ditës së Flamurit" 28 Nëntori	-Homazhe -Program kulturo-artistik Aktivitete tjera	28 nëntor 2019	• DKRS • Shoqatat e dala nga lufta
28.	Shpallja e "Sportistit të vitit 2019"	Organizim i ngjarjes ku do të shpallet sportisti i vitit	24 dhjetor 2019	• Sportistët nga Komuna e Vushtrrisë

Ky plan i punës brenda vitit 2019 mund të plotësohet varësisht prej nevojës për plotësime. Sidoqoftë, i njëjti përmban në vete prioritetet përkatësisht objektivat dhe aktivitetet e planifikuara gjatë vitit 2019.

Me rastin e diskutimeve në kuvend gjatë shqyrtimit, mirëpres sugjerimet të cilat do të mund të inkorporohen në tekstin e këtij plani apo bashkëngjiten në shtojcë.



Xhafer Tahiri

Kryetar i Komunës